



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”
Kolegji Universitar “BEDER”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Dr. Diana Kalaja

Dr. Emiljano Kaziaj

Maj 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Bachelor në "Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Komunikimit (Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 404, datë 12.07.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli I
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13.1	<ul style="list-style-type: none">Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	<ul style="list-style-type: none">Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021: 14 PAE /5 PAK
16	Numri i studentëve (për tre vite):	55 Studentë
17	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të parë Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” në Kolegjin Universitar Bedër ka nisur në vitin 2018, pas miratimit nga Ministria Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) me urdhër Nr. 404 datë 12.07.2018. Ky është procesi i parë i vlerësimit të jashtëm dhe zhvillohet në mbyllje të ciklit të parë të ofrimit të këtij programi 3-vjeçar.

Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është nën përgjegjësinë e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë.

Programi u ofron studentëve njohuri teorike dhe praktike në dy fusha të rëndësishme në komunikim, atë të Marrëdhënieve me Publikun dhe Marketingut. Si i tillë, programi synon të gjithë studentët që aspirojnë të nisin karrierat e tyre në këto dy fusha dhe pikëprerjet e tyre.

Në program ka aktualisht 55 studentë, të ndarë përkatësisht në 20 studentë, të cilët janë duke përfunduar ciklin e plotë tre-vjeçar; 19 studentë në vitin e dytë dhe 16 studentë janë duke përfunduar vitin e parë. Numri i studentëve në këto tre vite të ofrimit ka qenë i qëndrueshëm, pa studentë të larguar. Ndërkohë performanca e studentëve, ka ardhur në rritje me notën mesatare në hyrje, nga 7.5 (2018-2019) në 7.96 (2020-2021).

Në funksion të ofrimit të programit (vetëm për vitin e fundit 2020-2021), institucioni ka 14 pedagogë si personel akademik me kohë të plotë, prej të cilëve: 1 Përgjegjës departamenti; 6 lektorë dhe 7 asistentë lektorë. Ndërkohë për ofrimin e këtij programi (vetëm për vitin 2020-2021) angazhohen edhe 5 lektorë të jashtëm, prej të cilëve 1 me titull Dr. ndërsa 4 të tjerët me titullin Msc.

Programi ofron lëndë të ndara në katër tipologji: bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Ndër lëndët karakterizuese studentëve u ofrohen njohuri në Hyrje në Marrëdhëniet Publike, Bazat e Marketingut, Marketing dhe Marrëdhënie Publike online, Menaxhim i marrëdhënieve me klientin etj. Lëndët bazë ofrojnë njohuri në Hyrje në komunikimin masiv, Metodatat e Kërkimit shkencor, Gjuhë shqipe, etj. Lëndët ndërdisiplinore ofrojnë njohuri në fusha të ndryshme të komunikimit me një fokus në njohuri praktike si: E folura në publik, Komunikim biznesi, Komunikimi vizual, etj. Si lëndë plotësuese studentëve u ofrohen njohuri dhe mundësi në gjuhët e huaja (anglisht) dhe praktikë profesionale.

Institucioni përdor një sërë formash për matjen e performancës së studentëve duke përfshirë provimet finale, ato mes-semesteralet (gjysmë-finale), projekte dhe pjesëmarrje. Institucioni i kushton një vëmendje të theksuar mundësive të studentëve për praktika profesionale, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me biznese dhe kompani vendase.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nisi punën që në Janar 2021, me takimin e përbashkët dhe përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, ekspertës dhe stafit të ASCAL dhe me dakordësinë e KU BEDER u përcaktuan edhe datat e vizitave / takimeve pranë institucionit. Fillimisht u ra dakort që vizita/takimet të ishin të kombinura edhe online edhe fizita fizike. Po për arsye të situatës me pandeminë COVID -19 të dyja ditët e vizitës u realizuan online. Vizitat ishin në datat 23 dhe 25 Shkurt 2021 sipas një axhende të dakordësuar dhe u realizuan nëpërmjet platformës CISCO.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në www.ascal.al

Gjatë dy ditëve të takimeve online, u zhvilluan takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Përgjegjësën e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, Stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e karrierës, të marrëdhënieve me studentët dhe marrëdhënieve me jashtë, etj. Gjatë ditës së dytë u vizionua online edhe ambientet e KU BEDER si edhe u shikua një video e përgatitur për ambientet.

Gjatë takimeve online, nga grupi i vlerësimit të jashtëm u kërkua plotësimi me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar të programit të studimit. Materialet e kërkuara u plotësuan dhe u vendosën në platformën e ASCAL. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të KU BEDER.

Koordinator teknik nga ASCAL, në këtë vlerësim ka marrë pjesë ME. Renata Qatipi.

Më datë 06.05.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 33/8 Prot., datë 06.05.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Kolegji Universitar “BEDËR” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Kolegji Universitar “BEDËR” përcjell përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht përgjigjen për Draft–Raportin, me shkresë Nr. 18/3 Prot., datë 11.05.2021 “Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu”. Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet, sqaron si më poshtë:

Komenti i IAL:

Standardi IV.1, Kriteri 1: *Në këtë standard vihet në dukje se në dosjen e personelit të vënë në dispozicion të ekspertëve të jashtëm nga Zyra e Burimeve Njerëzore, nuk gjendet dëshmia e penalitetit.*

Në lidhje me këtë çështje sqarojmë se nga viti 2017, kur vërtetimi i gjendjes gjyqësore u përfshi në listën e dokumenteve që mundësohen përmes portalit e-albania, Zyra e Burimeve Njerëzore nuk e ka përfshirë më si dokumentacion në dosjen e personelit. Kjo zyrë mban gjithashtu edhe formularët e vetëdeklarimit në një dosje të veçantë. Për të vërtetuar këtë bashkëngjitur po ju përcjellim vërtetimin e gjendjes gjyqësore të një prej anëtarëve të personelit, si dhe formularin e fundit të vetëdeklarimit.

Evidencë shtesë nr.1: Kopje e vërtetimit të gjendjes gjyqësore

Evidencë shtesë nr.2: Kopje e formularit të vetëdeklarimit

GVJ: Bazuar në dokumentacionin shtesë të paraqitur nga institucioni [Evidenca shtesë nr 1] dhe sidomos në evidencën e formularit të vetëdeklarimit [Evidenca shtesë nr. 2], GVJ mendon se dosja e personelit është e plotë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. GVJ e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Standarti IV.1, Kriteri 3: Shpallja për vendet vakante në departamentin e Shkencave të Komunikimit për shkak të punimeve për përditësimin e websitit zyrtar, janë bërë nëpërmjet rrjeteve sociale të institucionit, ku janë shpallur të gjitha kriteret dhe afatet për aplikim të kandidatëve. Publikimi i shpalljeve në faqen zyrtare në internet, bëhet me afat të caktuar. Pas përfundimit të afatit, njoftimi hiqet nga website. Gjithmonë KU “Bedër” ka ndjekur procedura transparente për rekrutimin e personelit duke i kushtuar rëndësi përcjelljes së thirrjes për vende vakante të një auditor sa më i gjerë. Për ta vërtetuar procesin, po bashkëngjisim praktikën e ndjekur për shpalljen e vendit vakant dhe publikimin në Facebook.

Evidencë shitesë nr.3: Praktika e ndjekur për shpalljen e vendit vakant

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se procedura e shpalljes së vendeve vakante nga departamenti është transparente dhe respekton të gjitha hapat, sic është shpjeguar në dokumentacionin përkatës dhe vërtetuar me evidencën shitesë nr 3. GVJ e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Standarti IV.2, Kriteri 3: Në këtë standard thuhet: “Tema trajnimi të cilat e vënë theksin tek zhvillimi i mëtejshëm profesional i personelit në drejtim të metodave interaktive të zhvillimit të mësimdhënies; qasjen me në qendër studentin; hartimin e syllabuseve dhe integrimin e komponentëve të të mësuarit praktik, etj., janë të nevojshme.” Në lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë se në listën e trajnimeve të vëna në dispozicion, gjendet një i titulluar “Mësimdhënia dhe përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve” me trajnues: Prof. Asoc. Dr. R O, i realizuar më 10 tetor 2018. Kjo vërtetohet në listën e trajnimeve që po ju dërgojmë bashkëngjitur.

Evidencë shitesë nr.4: Lista e trajnimeve

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se evidenca shitesë e paraqitur nga insitucioni [Evidenca nr. 4], i përgjigjet komenteve të evidentuara nga GVJ në vlerësimin e kriterit 3, në standardin IV.2. GVJ e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Kriteri 4: Procesi i koordinimit të personelit nga ana e Zyrës së Burimeve Njerëzore, pavarësisht numrit të punonjësve pranë zyrës, është kryer gjithmonë me rigorozitet dhe me përpikmëri duke i kryer të gjithë detyrimet e vendosura nga legjisllacioni dhe më gjerë. U është dhënë rëndësi maksimale pjesës së rekrutimit, dokumentacionit, trajnimeve dhe çdo procesi, që mundëson mbarëvajtjen dhe koordinimin e personelit. Shtojmë që është mbajtur parasysh fakti se një sërë procedurash në lidhje me burimet njerëzore, siç është emërimi i lektorëve sipas ngarkesës mësimore, përditësimi i i CV-së në sistem, etj, bëhet përmes sistemit të automatizimit BIS. Menaxhimi i një sërë dokumentesh përmes këtij sistemi të automatizimit, lehtëson punën e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Për më tepër, sqarojmë se një sërë procedurash, që lidhen me komunikimin e lektorëve me kohë të pjesshme me departamentet, kryhen përmes koordinatoreve të departamentit.

GVJ: GVJ nuk e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ nuk ndryshon.**

Komenti i IAL:

Standardi IV.4, Kriteri 2: Në këtë standard është shprehur ideja se duhet një koordinim më i mirë mes departamentit dhe bibliotekës për të siguruar kopje fizike të mjaftueshme në bibliotekë për librat (në

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

anglisht) që përdoren si tekste të detyrueshëm në lëndët e këtij programi specifik, në mënyrë që sa më shumë studentë të programit të kenë mundësi të marrin kopje fizike, në të njëjtën kohë. Në lidhje me këtë pikë të evidentuar, mendojmë se nevojat e studentëve plotësohen më së miri përmes mundësisë që institucioni ka krijuar për bibliotekën online. Kontrata e firmosur me platformën JSTOR, u mundëson studentëve në çdo kohë një literaturë bashkëkohore, si libra, raporte, artikuj shkencore, kapituj të veçantë, teza masteri dhe doktorature, etj. Për ta bërë sa më të lehtë procesin, institucioni u ka mundësuar studentëve të përdorin platformën edhe përmes adresës së emailit, pa qenë nevojë të jenë present fizikisht në ambientët e bibliotekës. Për detaje në lidhje me mundësitë që ofron platforma JSTOR, lutemi t'i referoheni evidencës nr. 43, që ndodhet në listën e evidencave.

GVJ: Nga një vështrim më i thelluar dhe bashkërendim i informacioneve të përcjella GVJ e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Standardi IV.6, Kriteri 1: Në lidhje me konstatimin, se “Për këtë program, nuk ka një raport të dorëzuar për të ardhurat apo shpenzimet”, ju njoftojmë se Kolegji Universitar “Bedër” ka paraqitur një raport financiar në dosjen e vlerësimit të programit, e cila është dorëzuar në Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sporteve në fazën e licensimit të programit. Ky fakt është evidentuar edhe në përgjigjen tuaj për krieterin 2 të po këtij standardi. Sa i përket sugjerimit që plani i financimit “të reflektojë edhe shpenzime specifike për programin, të ndara në zëra të veçantë”, dëshirojmë të sqarojmë se formati i planit të financimit të dorëzuar në dosjen e aplikimit të programit është i përcaktuar nga MASR. Ndërkohë që formati i raportimit në lidhje me këtë çështje, ka marrë dhe aprovimin e ekspertëve të kontraktuar nga MASR, të cilët kanë vlerësuar dosjen e programit dhe kanë rekomanduar licensimin e tij.

GVJ: GVJ nuk e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë RVJ nuk ndryshon.

Komenti i IAL:

Standardi IV.6, Kriteri 3: Në këtë kriter konstatohet se Raporti i Auditimit, është i pafirmosur nga anëtarët e Komisionit të Auditimit. Në lidhje me këtë çështje dëshirojmë të sqarojmë se në faqen nr.8 të evidencës nr.49, vërtetohet se raporti i auditimit i përcillet departamentit të Shkencave të Komunikimit përmes shkresës me nr. protokollit 280/10, datë 3 tetor, 2019. Shkresa e lartpërmendur e administratorit të institucionit, ka bashkëngjitur dhe raportin e auditimit, me datë 16 shtator 2019, i cili është i firmosur nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Auditimit dhe nga koordinatoresha e departamentit të Shkencave të Komunikimit, në cilësinë e përfaqësueses të palës së audituar. Siç mund të vihet re, firma e anëtarëve të Komisionit të Auditimit, gjendet në secilën faqe të raportit. Dokumenti i pafirmosur, të cilit ju i referoheni, është njoftimi për auditim dhe jo raporti i auditimit.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se sqarimi i dhënë nga IAL për këtë kriter, është shterues. GVJ e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Nisur nga shpjegimet dhe evidencat shtesë të sipërpërmendura, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit “Bachelor” në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu është i mendimit se standardet dhe kriteret e përfshira në kapitullin IV: “Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit”, **përbushen plotësisht.**

GVJ **pranon** ta marrë në konsideratë dhe për këtë RVJ **ndryshon**

Komenti i IAL:

Standardi VI.1, Kriteri 2: Lidhur me përditësimin e faqeve të webit konstatimi juaj vjen si rrjedhojë e procesit të ndryshimit si dhe përditësimit të webit të institucionit. KU “Bedër” për këtë qëllim ka kontraktuar një web-designer i cili po punon për përmirësimin dhe përditësimin e tij.

Evidencë shtesë nr.5: Kontrata e shërbimit të lidhur me një specialist web-designer.

GVJ: GVJ **nuk e pranon** ta marrë në konsideratë dhe për këtë RVJ **nuk ndryshon**.

Komenti i IAL:

Standardi VI.2, Kriteri 1: Ndryshimi ndërmjet Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë konsiston në faktin që ky organ kolegjal kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit, ajo koordinon procesin e sigurimit të cilësisë si dhe nxjerr urdhra dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ndërsa Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është organi përgjegjës për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ, për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollin periodik dhe ndjekjen së tyre në institucion.

Funksionet e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale janë parashikuar në rregulloren e vetë komisionit dhe nuk përcaktohen në rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Funksionet Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale janë parashikuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje.

Evidencë shtesë nr.6: Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale

GVJ: Bazuar në dokumentacionin shtesë të paraqitur nga institucioni [evidenca nr. 6], GVJ mendon se sqarimi i dhënë nga IAL për këtë kriter, është shterues. GVJ e **pranon** ta marrë në konsideratë dhe për këtë RVJ **ndryshon**.

Kriteri 5

Lidhur me përditësimin e faqeve të uebit konstatimi juaj vjen si rrjedhojë e procesit të ndryshimit si dhe përditësimit të uebit të institucionit. KU “Bedër” për këtë qëllim ka kontraktuar një ueb-designer i cili po punon për përmirësimin dhe përditësimin e tij.

Evidencë shtesë nr.5: Kontrata e shërbimit të lidhur me një specialist ueb-designer.

Institucioni ka ofruar si evidence edhe një vlerësim të bërë së fundmi mbi kërkimin shkencor. Ky dokument përfshin gjetjet nga procesi i vlerësimit si dhe vendos afate kohore për realizimin e tyre. Janë marrë masa dhe çështjet u janë adresuar instancave përkatëse, sic do ta gjeni të pasqyruar dhe në raportin për zbatimin e planveprimit për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor.

Evidencë nr.7: Raporti për plotësimin e planveprimit për kërkimin shkencor

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr 2019, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

GVJ: GVJ nuk e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ nuk ndryshon**

Komenti i IAL:

Standardi VI.3, Kriteri 1: Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve siç është e parashikuar në planin Strategjik të KU “Bedër” pikërisht në pjesën III, Objektivat strategjike dhe strategjitë e zbatimit. Në të cilësohet rëndësia që institucioni i jep rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, gjë e cila ka si synim përmirësimin e programeve të studimeve.

Vlerësimi dhe raportimi i kërkimit shkencor dhe marrëdhënieve me jashtë bëhet edhe në rang departamenti dhe paraqiten në raportin vjetor të departamentit. Vlerësimi i pjesës financiare në rang departamenti bëhet në formën e pasqyrimit të kërkimit shkencor në zërat e projektbuxhetit të cilat hartohen nga departamenti në fillim të vitit akademik. Ndërsa pjesa i përket marrëdhënieve me jashtë për përmirësimin e programeve të studimit kjo është lehtësisht e verifikueshme në marrëveshjet që janë lidhur me institucione publike dhe private për kryerjen e praktikave profesionale si dhe marrëveshjeve të lidhura me objekt bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor, shkëmbimin e stafit dhe studentëve etj.

Evidencë shtesë nr.8: Praktika e hartimit të project buxhetit nga departamenti

Evidencë shtesë nr.9: Marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale

Evidencë shtesë nr.10: Marrëveshje bashkëpunimi për kërkimin shkencor, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, etj.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se IAL ka paraqitur sqarime të mjaftueshme për konstatimin e bërë në RVJ për këtë kriter dhe evidenca përforcuese të mjaftueshme [evidencat nr. 8, 9 dhe 10]. GVJ **e pranon** ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon**.

Komenti i IAL:

Standardi VI.3, Kriteri 3: Metodatat e tërthorta të vlerësimit janë implementuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë ku ka patur seksione të veçanta mbi:

- a) Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës;
- b) Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës;
- c) Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga KU “Bedër”;
- d) Pyetje konceptuale;
- e) Rekomandime nga studentët.

Metoda të drejtpërdrejta janë ato të të përfshira edhe në syllabus-in e lëndës si:

- a) Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;
- b) Vlerësime me notë dhe me pikë;
- c) Vlerësim të detyrave dhe të projekteve të kryera nga studentët;
- d) Vlerësimi i studentëve më të mirë duke ju ofruar çertifikata nderi;
- e) Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës profesionale.

Vëzhgimi i leksioneve në auditor nga përgjegjësi i departamentit dhe kolegët është një praktikë e njohur për KU “Bedër” deri para disa vitesh por është pasivizuar pasi është konceptuar si cënim i lirisë akademike, duke u argumentuar nga shumë kolegë si metodë e përdorur gjërësisht në arsimin parauniversitar.

Numri i personelit akademik në departament është i përshtatshëm që çështjet të diskutohen në një fokus grup, si rrjedhojë kjo bën të mundur që gjatë mbledhjeve të këshillit të departamentit të bëhen dhe vlerësime në lidhje me të gjitha çështjet problematike të hasura gjatë semestrit, duke mos i bërë të domosdoshme takimet me folkus grupe të veçanta pedagogësh.

Kriteri 4

Me studentët realizohen takime në grupe apo edhe individuale me anë të këshilltarit akademik, i cili ndjek mbarëvajtjen e çdo studenti që ka nën këshillim. Komentet apo sugjerimet e këtyre takimeve përcillen në departament dhe diskutohen në mbledhjet e këshillit të departamentit ose me anë të takimeve individuale me profesorë të ndryshëm.

Përveç pyetësorëve të plotësuar nga studentët, një instrument tjetër i matjes së cilësisë është dhe formulari i vetëvlerësimit që plotëson cdo pedagog, i cili përmban element si mësimdhënia, kërkimi shkencor, publikimet, konferencat, etj.

Vëzhgimi i leksioneve në auditor nga përgjegjësi i departamentit dhe kolegët është një praktikë e njohur për KU “Bedër” deri para disa vitesh, por është pasivizuar pasi është konceptuar si cënim i lirisë akademike, duke u argumentuar nga shumë kolegë si metodë e përdorur gjërësisht në arsimin parauniversitar.

Numri i personelit akademik në departament është i përshtatshëm që çështjet të diskutohen në një fokus grup, si rrjedhojë kjo bën të mundur që gjatë mbledhjeve të këshillit të departamentit të bëhen dhe vlerësime në lidhje me të gjitha çështjet problematike të hasura gjatë semestrit.

Evidencë shtesë nr.11: Formulari i vlerësimit të performancës së stafit.

GVJ: GVJ nuk e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë RVJ nuk ndryshon

Komenti i IAL:

Standardi VI.4, Kriteri 2: Në rregullore nuk janë parashikuar detyra specifike për secilin anëtar të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pasi është organ kolegjal dhe detyrat e këtij organi janë parashikuar në nenin 11, “Detyrat dhe Kompetencat e NJSBC”, të rregullores për funksionimin dhe organizimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Pozicioni i relatorit duke qenë se është pozicion tekniko-administrativ e bën të domosdoshëm parashikimin e detyrave të tij.

Vlen të theksohet se eksperti i jashtëm në momentin e emërimit të tij, nënshkruan edhe aneksin 1 terma referenca ku janë parashikuar detyrat pranë Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Evidencë shtesë nr.12: Aneks kontrate e Ekspertit të jashtëm për NJSBC

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se IAL i është përgjigjur konstatimeve të RVJ dhe e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon.**

Komenti i IAL:

Standardi VI.4, Kriteri 5: Në rregullore nuk janë parashikuar detyra specifike për secilin anëtar të NJSBC pasi është organ kolegjal dhe detyrat e këtij organi janë parashikuar në nenin 11 “Detyrat dhe Kompetencat e NJSBC” të rregullores për funksionimin dhe organizimin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Pozicioni i relatorit duke qenë se është pozicioni tekniko-administrativ e bën të domosdoshëm parashikimin e detyrave të tij. Vlen të theksohet se për ekspertin e jashtëm në momentin e emërimit të tij, nënshkruan edhe aneksin 1 terma referenca ku janë parashikuar detyrat pranë Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, GVJ mendon se IAL i është përgjigjur konstatimeve të RVJ dhe e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon**.

Komenti i IAL:

Standardi VI.5, Kriteri 1: Studentet kanë kontribuar për hartimin dhe përditësimin e anketave të zhvilluara nga NJSBC, duke qenë se kanë dhe përfaqësuesin e tyre pranë Njësisë, i cili është anëtar me të drejta të plota dhe paraqet sugjerimet e ardhura nga studentët.

Evidencë shtesë nr.13: Listprezenca e mbledhjes së anketës dhe materialin e anketës

GVJ: GVJ nuk e pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ nuk ndryshon**

Nisur nga shpjegimet dhe evidencat shtesë të sipërpërmendura, Grupi i vlerësimit të Brendshëm për Programin Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu është i mendimit se standardet dhe kriteret e përfshira në kapitullin VI. Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit bachelor” **përmbushen plotësisht.**

GVJ: GVJ pranon ta marrë në konsideratë dhe për këtë **RVJ ndryshon**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar BEDER, në respekt të rregulloreve të tij të brendshme, misionit të tij për t'u dhënë studentëve një edukim cilësor, ofron programe studimi që përshtaten mjaft mirë me interesat kombëtare dhe zhvillimin e vendit.			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit dhe specifiku programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Kjo është e shprehur në rregulloret e brendshme të programit të studimit “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” si edhe në Statutin e institucionit dhe organizimin e departamenteve, fakulteteve dhe KU BEDER në tërësi. Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër.pdf Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi organizimin akademik.pdf Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka targetuar atë pjesë të rëndësishme të rinisë që synon të përfaqëjë zhvillimet e reja në ekonomi dhe në epokën e digjitalizimit. Marrëdhëniet publike dhe komunikimi i marketimit janë ndër fushat e rëndësishme të komunikimit dhe ato sidomos kanë marrë një rëndësi të veçantë në zhvillimet e reja social ekonomike të vendit. Ky program studimi është i lidhur edhe me faktin se vendi ka nevojë për specialistë marketimi edhe në kushtet e fushatave për zgjedhjet politike, si për pushtetin qendror dhe lokal, ashtu edhe sepse ai përballet me zhvillimet e reja edhe në rang kombëtar dhe ndërkombëtar ku komunikimi, veçanërisht ai online, është mjaft i rëndësishëm. Institucioni ka hartuar një studim paraprak të tregut të punës, “ <i>Studim Tregu përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik</i> ” dhe aty ka të përshkruar edhe nevojat e tregut të punës dhe grupet e synuara. Studimi, i zhvilluar në periudhën Nëntor – Dhjetor 2019 ka dhënë indikacione dhe për nevojat e specialistëve në nivelin e parë në komunikimin publik dhe në marketim. Hapja e programit të studimit është e lidhur edhe me indikacionet e marra nga Strategjia kombëtare e punësimit dhe aftësisë 2014-2020. Evidenca 07: Rregullore e programit të studimit “Bachelor” në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Evidenca 26: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi “Peisazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri”			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka targetuar atë pjesë të rëndësishme të rinisë që synon të përfaqëjë zhvillimet e reja në ekonomi dhe në epokën e digjitalizimit. Marrëdhëniet publike dhe komunikimi i marketimit janë ndër fushat e rëndësishme të komunikimit dhe ato sidomos kanë marrë një rëndësi të veçantë në zhvillimet e reja social ekonomike të vendit. Ky program studimi është i lidhur edhe me faktin se vendi ka nevojë për specialistë marketimi edhe në kushtet e fushatave për zgjedhjet politike, si për pushtetin qendror dhe lokal, ashtu edhe sepse ai përballet me zhvillimet e reja edhe në rang kombëtar dhe ndërkombëtar ku komunikimi, veçanërisht ai online, është mjaft i rëndësishëm. Institucioni ka hartuar një studim paraprak të tregut të punës, “ <i>Studim Tregu përpara hapjes së programit profesional Multimedia dhe Dizajn Grafik</i> ” dhe aty ka të përshkruar edhe nevojat e tregut të punës dhe grupet e synuara. Studimi, i zhvilluar në periudhën Nëntor – Dhjetor 2019 ka dhënë indikacione dhe për nevojat e specialistëve në nivelin e parë në komunikimin publik dhe në marketim. Hapja e programit të studimit është e lidhur edhe me indikacionet e marra nga Strategjia kombëtare e punësimit dhe aftësisë 2014-2020. Evidenca 07: Rregullore e programit të studimit “Bachelor” në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Evidenca 26: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi “Peisazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri”			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Kolegji Universitar Bedër (KU Bedër), ka hartuar një <i>“Plan Strategjik Institucional 2018-2023”</i> ku jep objektivat strategjike të tij si institucion dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Ndër objektivat e përshkruar në këtë plan përfshihet edhe ai për një arsim cilësor dhe për një zhvillim të qëndrueshëm në arsim, duke patur parasysh gjithnjë edhe komponentin e përgjegjshmërisë sociale.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Gjithashtu, në Statutin e KU Bedër, Neni 4 përcakton misionin dhe qëllimin e tij. Aty sanksionohet se “... Kolegji Universitar Jopublik “Bedër” ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë...”</p> <p>Më tej në pikën 3 të po këtij neni përcaktohet se “...Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti.”</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” në respekt të Statutit dhe Planit Strategjik të KU Bedër është në përputhje të plotë me interesat kombëtare duke synuar përgatitjen e specialistëve në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit marketing.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” synon “... përgatitjen e individëve të kualifikuar në fushën e komunikimit dhe të marketingut, të marrëdhënieve publike, në fushën e mediave të reja, multimedias dhe marketingut të integruar, si dhe në fusha të ngjashme me to, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si edhe mbështetjen e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe të mbarë shoqërisë, në përputhje edhe me zhvillimet e teknologjisë bashkëkohore.”</p> <p>Kjo duket si në tërësinë e lëndëve që trajtohen në këtë program studimi ashtu edhe në aktivitetet e veçanta të organizuara si pjesë e disa prej lëndëve specifike të lidhura me zhvillimet social politike në vend.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” i ndërtuar nga Departamenti të Shkencave të Komunikimit është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU Bedër dhe me misionin e tij. Edhe misioni i vetë Departamentit është “... përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e komunikimit, të marrëdhënieve publike dhe komunikimit të marketingut, të marrëdhënieve me median dhe publikun, si edhe në fusha të ngjashme me to...”</p>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e	Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë në vend institucioni ka hartuar rregulloren e tij themelore, statutin, organigramën dhe më pas edhe rregulloret zbatuese për secilin nga programet e studimeve.

drejtimet akademike të institucionit.	<p>Edhe programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është hartuar dhe realizohet në zbatim të këtyre akteve rregullatore të KU BEDER. Programi është pjesë e departament të Shkencave të komunikimit dhe Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë.</p> <p>Të gjitha kompetencat profesionale që fitohen nga programi, përmbajtja, struktura, emërtimi, organizimi këtij programi studimi janë në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit.</p> <p>Evidenca 02: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Evidenca 05: Rregullorja themelore e KU Bedër, neni 52 Evidenca 07: Rregullore e programit të studimit “Bachelor” në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 08: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023 Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>KU BEDER ka aprovuar rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”. Rregullorja përcakton synimin e këtij programi që “... Nëpërmjet një gërshetimi të mirë-organizuar të anës teorike me praktikën në kushte dhe mundësi fizike bashkëkohore” të sigurojë përgatitje cilësore të studenteve.</p> <p>Në nenin 4 të kësaj rregulloreje jepen edhe objektivat e tij “për të përgatitur profesionistë të aftë në respektimin e deontologjisë dhe etikës profesionale, në analizën e thelluar shkencore të fakteve dhe të situatave të ndryshme, të cilat synohet që të arrihen edhe nëpërmjet përfitimit nga ana e studentëve të një kulture të gjerë pluraliste, bashkëkohore mbi mënyrën e mendimit dhe konceptimit të situatave dhe ngjarjeve.”</p> <p>Gjithashtu, departamenti ka si objektiv që “... përmes ndërthurjes së teorisë me praktikën, programi synon të përgatisë studentë me aftësi teorike dhe shprehi praktike, të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e marrëdhënieve publike, komunikimit të marketingut, komunikimit në përgjithësi dhe marrëdhënieve të tyre me median.”</p> <p>Bazuar në kurikulën e këtij programi, studentët në përfundim të tij do të kenë krijuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësi të qëndrueshme komunikimi në shkrim dhe prezantim; ▪ Aftësi profesionale që nga lindja e mendimit deri tek zbatimi; ▪ Eksperiencë reale nëpërmjet praktikave profesionale, pranë një mase të gjerë organizatash dhe institucioneve lokale dhe ndërkombëtare; ▪ Njohuri mbi konceptet dhe teoritë themelore të fushës; ▪ Aftësim për punë individuale dhe në grup;

	<ul style="list-style-type: none"> Aftësi për t'iu përgjigjur kërkesave të një industrie dinamike dhe tërheqëse. 			
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>KU BEDER ka kryer një studim në tregun vendas të punës duke identifikuar se cilat janë potencialet që ka tregu për studentet e diplomua në këtë program studimi. Studimi është gjithëpërfshirës dhe jep informacione statistikore si edhe vlerësime cilësore për tregun e marketimit dhe komunikimit.</p> <p>Në studim jepet statistika për:</p> <ul style="list-style-type: none"> Sektorin e reklamës dhe marketimit; Sektorin e marrëdhënieve me publikun Marketimin dixhital Tregtinë online <p>Gjithashtu studimi ka edhe një listë të zgjeruar të transmetuesve dhe prodhuesve audiovizivë si edhe portaleve online.</p> <p>Përsa i takon studimit në tregun ndërkombëtar të punës, kjo është e vështirë të kërkohet në një program studimi që ofrohet vetëm në gjuhën shqipe.</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, si edhe nga diskutimi me studentë pjesëmarrës në program, kuptohet gjithanshmëria e programit që i përgatit ata për tregun e punës.</p> <p>Lista e lëndëve të formimit karakterizues dhe atyre me zgjedhje, ka gërshetimin e duhur midis njohurive praktike me ato teorike dhe kompetencën profesionale. Kjo i ndihmon studentët në gjetjen e hapësirave për të bërë një hyrje sa më të lehtë në tregun e punës.</p> <p>Edhe zhvillimi i praktikave profesionale si pjesë e kurikulës mësimore ndikon për një përshtatje sa më të mirë me tregun e punës.</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Evidenca 26: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbi "Peisazhin e fushës së medias dhe komunikimit në Shqipëri"</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Departamentin i Shkencave të Komunikimit, në përbërje të në Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është njësi bazë që ofron programin e studimit Bachelor në "Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu".</p> <p>Përbërja e stafit akademik të angazhuar në këtë fakultet si edhe në departament si njësi bazë që ofron programin tregojnë se kanë kapacitetet e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Nga shikimi i CV të personelit akademik, si me kohe të plotë ashtu edhe stafi i ftuar të japë lëndë specifike, tregohet se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi. Stafi akademik ka eksperiencën akademike dhe përvoja</p>

	profesionale në organizata biznesi që më së miri japin knoë-hoë e duhur për realizimin e këtij programi studimit. Lëndët specifike të programit të lidhura me informacionet praktike dhe punën e përditshme të një specialist realizohen nga ana përfshirja në mësimdhënie e ekspertëve të fushës së medias, komunikimit dhe marketingut. Kjo është një ndihmë e madhe për studentët.			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel Bachelor edhe në nivelin Master, të gjitha të lidhura me shkencat e komunikimit të tilla si: (i) Programi Bsc në Shkenca Komunikimi; (ii) Program Profesional në Multimedia dhe Grafik Dizajn; (iii) Programi Msc Shkenca Komunikimi – profilet: Gazetari; Marrëdhënie me Publikun; (v) Master Profesional në Komunikim Marketingu. Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, Emërtimi i programit të studimit, Kodi i programit të studimit (megjithëse në këtë program studimi janë kodifikuar vetëm lëndët), orientimi, gjuha e studimeve, forma e studimeve, periudha e referencës, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe përndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane. Siç shihet edhe nga programet e tjera të ofruara ato përshtaten me klasifikimin/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimit (KKK) ka të përcaktuar Nivelin 6 të programit. Evidenca 3: Rregullore mbi Organizimin Akademik Evidenca 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit “Bachelor“ në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionin KU BEDER, si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programeve të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative.

	<p>Departamenti bën edhe koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të shkencore, ëorkshope, seminare etj që mund të jenë pjesë e një lënde apo e disa grup lëndësh që zhvillohen në departament. Këshilli i Departamentit përcakton këshilltarët akademikë, përfaqësuesin e departamentit në zyrën e këshillimit të karrierës dhe zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Evidenca 3: Rregullore mbi Organizimin Akademik Evidenca 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit “Bachelor“ në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 45: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike; Evidenca 46: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Kolegji Universitar BEDER ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” janë vendosur bashkëpunime me një universitet në Rumani dhe një tjetër në Kroaci. Këto bashkëpunime janë si në drejtim të marrjes së eksperiencës lidhur me kurikulat mësimore, ashtu edhe lidhur me programet dhe mundësitë e shkëmbimit të studentëve.</p> <p>Gjithashtu KU BEDER, dhe specifikiisht departamenti ka lidhur memorandume bashkëpunimi me kompanitë mediatike që veprojnë në vend si “Iceberg Communication”, “New Media Communication” dhe “NewMedia Digital”. Këto bashkëpunime ndihmojnë si në realizimin e objektivave të programeve mësimore, ashtu edhe në krijimin e mundësime më të gjera për studentët për zhvillimin e praktikave, përfshirjen në aktivitete extarkurikulare si edhe njohjen e tregut të punës për perspektiva të mëtejshme punësimi.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit harton Raportin Vjetor të aktivitetit përgjatë një viti akademik. Elementët përbërës të raportit janë përshkrimi për të gjithë programet e studimit që ofrohen duke dhënë tregues statistikor dhe arritje cilësore. Raporti vjetor përmban edhe veprimtaritë e ndryshme akademike, sociale dhe projekte e zhvilluara nga departamenti gjatë një viti. Në raport evidentohen edhe aktivitetet që janë organizuar duke specifikuar bashkëpunimet e ndryshme me aktorë vendas dhe institucione ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit i përfshin studentët e tij në praktika profesionale sipas programeve të studimit. Për këtë një ndihmojnë marrëveshjet e nënshkruara edhe me si “Iceberg Communication”, “New Media Communication” dhe “NewMedia Digital”. Kjo vërtetohet nga Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020, dhe nga shembulli i shkresës drejtuar një kompanie për realizimin e praktikave mësimore. Gjithashtu në syllabusin e lëndës “Praktika profesionale” saktësohet se “...Studentët, gjatë praktikës profesionale mbështeten dhe udhëhiqen nga një këshilltar i përcaktuar nga departamenti.”</p> <p>Ndërkohë, nuk kemi evidence të shkruar nëse çdo institucion ku studentët shkojnë ka një person të dedikuar që merret vetëm me studentët, por në takimin online me ta u informuam se ata gjejnë bashkëpunim të mirë në institucionet ku shkojnë për praktikën mësimore. Gjithashtu, disa nga drejtuesit e organizmave mediatike ku studentët shkojnë për praktika, janë edhe pedagogë</p>

	<p>të jashtëm në programet e KU Beder, duke shërbyer edhe si një urë lidhëse midis mësimin dhe praktikës edhe nga pikëpamja institucionale.</p> <p>Më tej, këto institucione i përfshijnë studentët edhe në aktivitetet që ata organizojnë si në kryerjen e sondazheve, realizimin e projekteve mediatike etj. (sipas bisedës me studentët dhe pedagogët edhe gjatë takimeve me ta)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Raporti Vjetor i Departamenti i Shkencave të Komunikimit përshkruan edhe aktivitetet e ndryshme trajnuese që institucioni ka ofruar për studentët e tij sipas programeve të studimit.</p> <p>Në programin Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” janë zhvilluar seminarët MarCOM, “Komunikimi në biznes me të ftuar drejtuesen e kompanisë “Iceberg Communication”, 14 nëntor 2019, takimet “Studenti dhe Profesionit” të zhvilluara në datat 4 nëntor 2019; 17 dhe 23 dhjetor 2019; 9 janar 2020; 22 prill 2020; 7, 8, 11 maj 2020.</p> <p>Gjithashtu janë zhvilluar edhe trajnime profesionale, si ato me datat 20 nëntor 2019 pranë Institutit Shqiptar të Medias; në datat 14, 15, 22 janar 2020 pranë Ministrisë së Kulturës në Tiranë dhe organizatës Mc.Cann Tirana, etj.</p> <p>Evidenca 3: Rregullore mbi Organizimin Akademik</p> <p>Evidenca 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë;</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit “Bachelor“ në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”;</p> <p>Evidenca 45: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike;</p> <p>Evidenca 46: Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<p>Standardi II.1 Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në</p>	<p>Programi e studimit Bsc në "Marrëdhënie publike dhe komunikim marketingu" të KU BEDER është organizuar në lëndë dhe module, të vlerësuar me kredite sipas legjislacionit në fuqi.</p>

<p>kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ai është i organizuar në tre vite mësimore me 6 semestra. Sipas Rregullores së programit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, Neni 16 jepte lista e plota e disiplinave dhe veprimtarive të tjera formuese. Sipas kësaj rregulloreje dhe Raportit Vjetor të Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2019-2020 janë të përcaktuara 13 lëndë në vitin e parë; në vitin e dytë janë 12 lëndë nga të cilat 11 të detyrueshme dhe 1 me zgjedhje, në semestrin e dytë; dhe në vitin e tretë janë 11 lëndë nga të cilat 9 të detyrueshme dhe 2 me zgjedhje në secilin semestër.</p> <p>Totali i krediteve të lëndëve për të tre vitet është 180 ECTS. Viti akademik ka 32 javë mësimore. Forma e studimit është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është shqip.</p> <p>Sipas rregullores së programit të studimit, lëndët janë të ndarë në kategoritë e lëndëve A - Bazë; B -Karakterizuese, C – Ndërdisciplinore; D – Plotësuese; E – Detyrime Përmbyllëse, në zbatim edhe të Udhëzimit nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” si edhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p> <p>Neni 28 i rregullores së programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” përcakton edhe mundësinë e semestrave të verës që rregullohen me një rregullore të veçantë. Ofrimi i lëndëve në semestrat e verës realizohet në bazë të kërkesave të studentëve për çdo lëndë specifike. Në semestrin e verës, për studentët e ciklit të parë të studimit mund të merren maksimumi 18 kredite.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” si edhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” në Nenin 5 përcakton rezultatet e dhe aftësitë që synohet të marrë studenti në përfundim të programit të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Aftësi të qëndrueshme komunikimi në shkrim dhe prezantim; ▪ Aftësi profesionale që nga lindja e mendimit deri në zbatim; ▪ Eksperiencë reale nëpërmjet praktikave profesionale, pranë një game të gjerë organizatash dhe institucioneve lokale dhe ndërkombëtare; ▪ Njohuri mbi konceptet dhe teoritë themelore të fushës; ▪ Aftësim për punë individuale dhe në grup; ▪ Aftësi për t’iu përgjigjur kërkesave të një industrie dinamike dhe tërheqëse.
<p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Këto aftësi të fituara si nga pikëpamja teorike ashtu edhe praktike e mundësojnë që studenti të fitojë njohuri në specialitet të ndryshme në fushën e komunikimit.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një</p>	<p>Këto aftësi të fituara si nga pikëpamja teorike ashtu edhe praktike e mundësojnë që studenti të fitojë njohuri në specialitet të ndryshme në fushën e komunikimit.</p>

<p>fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Edhe sipas përcaktimit në rregulloren e programit të studimit dhe nga vizionimi i syllabuseve të lëndëve japin informacionet e nevojshme si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga ana praktike e lëndëve.</p> <p>Nga diskutimet në takimet virtuale me stafin e departamentit, si edhe me grupin e studentëve pjesëmarrës në takimet online u theksua marrja e informacioneve teorike dhe praktike.</p> <p>Pjesa teorike e mjaft prej lëndëve është e përditësuar me informacionet dhe punohet që ajo të plotësohet e përditësohet në vazhdimësi. Viti i parë vendos themelet sidomos në formimin e studentëve me parimet themelore dhe njohuritë bazë të fushës (p.sh: Hyrje në Komunikimin masiv, Teoritë e komunikimit, Marrëdhënie Publike etj). Këto informacione plotësohen me lëndët karakterizuese në vitin e dytë e të tretë të tilla si “Shkrim Raportim Lajmi”, “Metodat e Redaktimit”, “Gazetaria Ekonomike”, “Marketing mediatik” “Intervistimi” etj.</p> <p>Nga pikëpamja profesionale, studentët në të tre vitet e shkollimit në programin Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” plotësojnë një kuadër të aftësive për të mundur zgjidhjen e çështjeve profesionale në praktikën e përditshme të punës. Puna si specialist i marrëdhënieve me publikun dhe komunikimi në marketing është një proces që çdo situatë është e re, sepse secili klient është i ndryshëm dhe ka synime të veçanta dhe specialisti i marketingut është çdo ditë përballë situatave të reja për të zgjidhur. Tërësia e lëndëve që ka ky program i përgatit studentët për ti adresuar më së mirë kërkesat specifike.</p>						
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është ndërtuar në bazë të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Neni 16 i kësaj rregulloreje përcakton kreditet sipas sistemit ECTS si edhe mënyrat e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve. Në programin e studimit janë të përcaktuara që studimet do të përfshijnë leksione, seminare, ushtrime, pune në grup në projekte dhe detyra, si edhe praktikë mësimore.</p> <p>Po kjo rregullore e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” përcakton të drejtat dhe detyrimet e studentëve.</p> <p>Pas përfundimit të programit të lëndëve, plotësimit të krediteve dhe notave të detyrueshme për diplomim nga programi i studimit në fjalë, studentit i lëshohet Diploma Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.”</p>						
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët janë të kategorizuar nga A, B, C, D, E si edhe të ndara në të detyrueshme dhe me zgjedhje nga studentët. Sipas rregullores së programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ato ndahen në:</p> <table data-bbox="587 1921 1493 2018"> <tr> <td>A – Lëndë Bazë</td> <td>32 ECTS</td> <td>17.78%</td> </tr> <tr> <td>B – Lëndë Karakterizuese</td> <td>96 ECTS</td> <td>53.33%</td> </tr> </table>	A – Lëndë Bazë	32 ECTS	17.78%	B – Lëndë Karakterizuese	96 ECTS	53.33%
A – Lëndë Bazë	32 ECTS	17.78%					
B – Lëndë Karakterizuese	96 ECTS	53.33%					

	C – Lëndë Ndërdisciplinore	26 ECTS	14.44%
	D – Lëndë Plotësuese	20 ECTS	11.11%
	E – Detyrime Përmbyllëse	6 ECTS	3.34%
	Totali	180 ECTS	100%
	<p>Ndarja e mësipërme është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018 për ndarjen e krediteve në programet e studimit.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”;</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</p> <p>Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” si edhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Në strukturën organizative të KU BEDER, janë dy fakultete, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Ky i fundit ka në përbërje të tij katër departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Departamenti i Shkencave të Komunikimit; (ii) Departamenti i Drejtësisë; (iii) Departamenti i Shkencave Islame; (iv) Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë është njësia kryesore dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësia bazë për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”.</p> <p>Kolegji Universitar Bedër, u çel në prill të vitit 2011 me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 286, datë 6.4.2011, me anë të të cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë.</p> <p>KU BEDER është akredituar Bordi i Akreditimit të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë me vendim e Bordit nr. 101, datë 10.11.2017, “Për akreditimin periodik të institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji universitar “Beder””. Ky akreditim është me kohëzgjatje akademike 4 vite mësimore, me afat vlefshmëri deri 09/11/2021.</p> <p>Evidenca nr. 78: Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar “Bedër”</p>

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është koordinatori akademik i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”.</p> <p>Sipas rregullores së këtij programi studimi, përcaktohet se departamenti zgjedh një pedagog këshilltar akademik për çdo klasë. Në nenin 9 të kësaj rregulloreje janë të përcaktuar të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e këtij këshilltari akademik. Në të 12 pikat që rregullorja përshkruan si detyra të këshilltarit akademik janë edhe ato që lidhen me sigurimin e informacionit të nevojshëm që studentët të jenë të suksesshëm gjatë këtij programi, në përzgjedhjen e lëndëve përmbushjen e krediteve, etj. Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentët si për veprimtarinë akademike ashtu edhe për pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme jashtë-kurrikulare/sociale. Këshilltari akademik siguron edhe orientimin e studentëve në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.</p> <p>Sipas Vendimit të Këshillit të Departamentit datë 28 tetor 2020, tre pedagogë të brendshëm janë këshilltarë akademikë për tre programet e ciklit të parë dhe drejtuesi i departamentit është këshilltar akademik për dy programet e ciklit të dytë, Master.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Ndërtimi organizativ i Fakultetit dhe Departamentit përmbush detyrimet ligjore për mënyrën e organizimit të strukturave akademike. Fakulteti ka personel akademik administrative, ndihmës dhe personel administrative. Fakulteti ofron programe ne ciklin e parë dhe të dytë si edhe programe profesionale 2 vjeçar studimi.</p> <p>Konkretisht programet e fakultetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programe studimi me kohë të plotë në Ciklin e Parë të Studimeve: (i) Bsc në Shkenca Komunikimi; (ii) Bsc në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” (iii) Bsc në Shkenca Islame; (iv) Bsc në Drejtësi; (v) Bsc në gjuhë dhe letërsi angleze; (vi) Bsc në Arsimit parashkollor dhe fillor; (vii) Bsc në Psikologji këshillimi dhe pedagogji. • Programe studimi në Ciklin e Dytë: (i) Msc në Shkenca Komunikimi me profil “Gazetari” dhe “Marrëdhënie publike”; (ii) Master Profesional në “Komunikim Marketingu” (iii) Msc në Drejtësi me profil “E drejtë penale” dhe “E drejtë Ndërkombëtare”; (iv) Msc në “Shkenca moderne islame”; (v) Msc në “Shkenca themelore islame”; (vi) Msc në “Psikologji këshillimi dhe pedagogji”; (vii) Program i integruar i studimit të ciklit të dytë: “Master i Shkencave” në “Drejtësi”. • Program Profesional 2-vjeçar “Multimedia dhe Dizajn Grafik” (2 vite). <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësia bazë për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, ka nga nëntë anëtarë stafit akademik me kohë të plotë, nga të cilët katër zotërojnë të paktën gradën "Doktor" dhe një personel ndihmës akademik. Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Komunikimit ka një eksperiencë prej 10 vitesh në këtë institucion dhe katër vite në pozicionin e përgjegjës të departamentit.</p>

	Duke vërejtur organigramën e KU BEDER dhe organizimin strukturor të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, vihet re se plotësohen kriteret ligjore të e përcaktuara për sa i përket organizimit dhe strukturën së tij akademike.																																																																																																																																											
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka një staff akademik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.</p> <p>Njësia Kryesore / Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka pasur, sipas viteve:</p> <table border="1" data-bbox="676 533 1378 696"> <thead> <tr> <th></th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>Staf ndihmës</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti 2018-2019</td> <td>28</td> <td>31</td> <td>1</td> <td>60</td> </tr> <tr> <td>Viti 2019-2020</td> <td>28</td> <td>27</td> <td>1</td> <td>56</td> </tr> <tr> <td>Viti 2020-2021</td> <td>32</td> <td>33</td> <td>1</td> <td>66</td> </tr> </tbody> </table> <p>Stafi sipas shkallës së kualifikimit/titujve:</p> <table border="1" data-bbox="568 786 1474 1016"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Të dhënat për stafin e Fakultetit</th> <th colspan="2">Viti 2018-2019</th> <th colspan="2">Viti 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof. Assoc.</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr/PHD</td> <td>10</td> <td>10</td> <td>11</td> <td>8</td> <td>13</td> <td>11</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>16</td> <td>18</td> <td>15</td> <td>16</td> <td>17</td> <td>19</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>28</td> <td>31</td> <td>28</td> <td>27</td> <td>32</td> <td>33</td> </tr> </tbody> </table> <p>Njësia Bazë / Departamenti i Shkencave të Komunikimit kishte:</p> <table border="1" data-bbox="600 1095 1455 1258"> <thead> <tr> <th>Të dhënat për stafin e Departamentit</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>Staf ndihmës</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti 2018-2019</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>18</td> </tr> <tr> <td>Viti 2019-2020</td> <td>11</td> <td>8</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Viti 2020-2021</td> <td>9</td> <td>11</td> <td>1</td> <td>21</td> </tr> </tbody> </table> <p>Njësia Bazë / Departamenti i Shkencave të Komunikimit sipas kualifikimit:</p> <table border="1" data-bbox="568 1337 1474 1568"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Të dhënat për stafin e Departamentit</th> <th colspan="2">Viti 2018-2019</th> <th colspan="2">Viti 2019-2020</th> <th colspan="2">Viti 2020-2021</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td></td> <td>-</td> <td></td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Prof. Assoc.</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PHD</td> <td>4</td> <td>3</td> <td>6</td> <td>3</td> <td>4</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>4</td> <td>5</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>9</td> <td>8</td> <td>11</td> <td>8</td> <td>9</td> <td>11</td> </tr> </tbody> </table> <p>Të dhënat e mësipërme tregojnë se njësia bazë dhe kryesore përmbushin edhe raportin student/pedagog. Në shkallë fakulteti ky raport aktualisht është 16:1. Ndërsa për departamentin e Shkencave të Komunikimit aktualisht është 8:1.</p> <p>Shtojca 1 tabelat 1- 2</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”.</p>					PAE	PAK	Staf ndihmës	Në total	Viti 2018-2019	28	31	1	60	Viti 2019-2020	28	27	1	56	Viti 2020-2021	32	33	1	66	Të dhënat për stafin e Fakultetit	Viti 2018-2019		Viti 2019-2020		Viti 2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	1	1	1	1	1	1	Prof. Assoc.	1	2	1	2	1	2	Dr/PHD	10	10	11	8	13	11	Msc	16	18	15	16	17	19	Total	28	31	28	27	32	33	Të dhënat për stafin e Departamentit	PAE	PAK	Staf ndihmës	Në total	Viti 2018-2019	9	8	1	18	Viti 2019-2020	11	8	1	20	Viti 2020-2021	9	11	1	21	Të dhënat për stafin e Departamentit	Viti 2018-2019		Viti 2019-2020		Viti 2020-2021		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	-		-		-	-	Prof. Assoc.	-	1	-	1	-	1	Dr/PHD	4	3	6	3	4	4	Msc	5	4	5	4	5	6	Total	9	8	11	8	9	11
	PAE	PAK	Staf ndihmës	Në total																																																																																																																																								
Viti 2018-2019	28	31	1	60																																																																																																																																								
Viti 2019-2020	28	27	1	56																																																																																																																																								
Viti 2020-2021	32	33	1	66																																																																																																																																								
Të dhënat për stafin e Fakultetit	Viti 2018-2019		Viti 2019-2020		Viti 2020-2021																																																																																																																																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																																																																																						
Prof.Dr	1	1	1	1	1	1																																																																																																																																						
Prof. Assoc.	1	2	1	2	1	2																																																																																																																																						
Dr/PHD	10	10	11	8	13	11																																																																																																																																						
Msc	16	18	15	16	17	19																																																																																																																																						
Total	28	31	28	27	32	33																																																																																																																																						
Të dhënat për stafin e Departamentit	PAE	PAK	Staf ndihmës	Në total																																																																																																																																								
Viti 2018-2019	9	8	1	18																																																																																																																																								
Viti 2019-2020	11	8	1	20																																																																																																																																								
Viti 2020-2021	9	11	1	21																																																																																																																																								
Të dhënat për stafin e Departamentit	Viti 2018-2019		Viti 2019-2020		Viti 2020-2021																																																																																																																																							
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																																																																																						
Prof.Dr	-		-		-	-																																																																																																																																						
Prof. Assoc.	-	1	-	1	-	1																																																																																																																																						
Dr/PHD	4	3	6	3	4	4																																																																																																																																						
Msc	5	4	5	4	5	6																																																																																																																																						
Total	9	8	11	8	9	11																																																																																																																																						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>																																																																																																																																								
				<p>X</p>																																																																																																																																								

Standardi II.3 Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamentit të Shkencave të Komunikimit si njësia bazë e programit të studimit ka informacionin e duhur për strukturimin e programit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”.</p> <p>Departamenti disponon të gjithë tërësinë e rregulloreve të nevojshme për fillimin e këtij programi studimi, Planin Strategjik të zhvillimit të KU BEDER, Statutin e tij, Rregulloren themelore, Rregulloren e Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, Rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e sekretarisë mësimore.</p> <p>Departamenti përpara fillimit të programit të studimit ka zhvilluar edhe një studim për tregun për të parë se si do të përshtatet ky program me kërkesat e tregut dhe sa janë mundësitë përthithëse të tij.</p> <p>Sipas strukturës dhe organigramës së KU BEDER, Departamenti e përcjell këtë informacion edhe në Fakultet si njësia kryesore</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” zhvillohet në tre vite akademike/ 6 semestra. Në përfundim të programit studentët fitojnë 180 kredite të përcaktuara sipas sistemit ECTS, të ndara barazisht nga 60 kredite në secilin vit.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Për të përmbyllur këtë cikël të studimit, studentët duhet të kryejnë edhe praktikën profesionale dhe punimin e diplomës të cilat janë në vitin e tretë akademik dhe kanë respektivisht 5 ECTS dhe 6 ECTS.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu“ ka 36 lëndë të ndara në të detyrueshme 33 dhe lëndë me zgjedhje 3.</p> <p>Gjithashtu lëndët janë të klasifikuara sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin e studimit, në A, B, C, D dhe E. Të gjitha specifikimet e lëndëve janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e Programit të Studimit edhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p>Programi mësimor është i ndarë në module, orë leksionesh, seminaresh të cilat reflektojnë edhe numrin e krediteve që ka secila lëndë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit. Tërësia e syllabuseve të secilës lëndë në programin e studimit jep informacionin më të detajuar për çfarë do të ndodhë në auditorë dhe ngarkesën e punës që e pret studentin orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin dhe vlerësimin.</p> <p>Syllabuset japin edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe detyrimet që duhet të përmbushin studentët për të marrë kreditet.</p> <p>Dy shembuj nga vlerësimi i dijeve gjatë vitit bëhet si më poshtë:</p> <p>Lënda “Multimedia” – detyrueshme vlerësohet:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - 10% pjesëmarja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve - 30% dorëzimi i detyrës së kursit - 20% provimi i ndërmjetëm/moduli - 40% provimi përfundimtar <p>Lënda “Tregtia online” – detyrueshme vlerësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10% projekte /pjesëmarja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve - 25% projekte semestrare - 5% quiz - 20% provimi i ndërmjetëm/moduli - 40% provimi përfundimtar <p>Si luhatje të kufinjëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5-10% pjesëmarja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve - 10-20% projekte/detyrat/laboratorët - 20-30% testimet gjatë vitit - 40-50% provimi përfundimtar <p>Nenet 18 – 21 japin respektivisht “Rregjistrimin për një lëndë, lënien e lëndës dhe detyrimin për frekuentim”, “Punimin e diplomës”, “Notat, provimet, kalueshmëria”, “Studentët kalues, jo kalues”.</p> <p>Për frekuentimin e studentëve KU Bedër ka vendosur detyrim 70% për lëndët teorike dhe 80% për laboratorët.</p> <p>Sistemi i vlerësimit është i klasifikuar edhe me vlerësimin me pikë nga 0-100 edhe me sistemin respektiv me shkronja nga F deri në A.</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite; Shtojca 1” tabelat 15</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme të pranimit janë ato të hartuara nga Ministria e Arsimit sipas VKM respektive. Kriteret specifike të pranimit hartohen nga Departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik i KU BEDER dhe u përcillen institucioneve të linjës për tu vendosur/ përditësuar në portalin U-Albania.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” në neni 8 paraqet te detajuara kushtet e pranimit dhe regjistrimit në këtë program në BEDER.</p> <p>Gjatë kohës së regjistrimit, studenti nënshkruan nj kontratë me KU BEDER në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Neni 12 i kësaj rregulloreje shpjegon edhe mundësitë e transferimit nga/në institucione të tjera të arsimit të lartë.</p>

	<p>Në nenin 33 janë parashikuar edhe ndërprerja e programit të studimit për arsye individuale.</p> <p>Në nenin 37 shpjegohen edhe “transferimet e studimeve”. Për këtë KU BEDER/Departamenti ngre një komision “ad hoc” që bën njohjen e krediteve në rast transferimesh.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që ata të kenë informacionin e nevojshëm për programin mësimor. Nga evidencat e syllabuseve të dorëzuara me dosjen shikohet se syllabuset kane formatin e miratuar sipas udhëzimeve dhe legjislacionit aktual në fuqi dhe elementët përbërës të tyre siç janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Pedagogu i lëndës/ mundësitë e kontaktit elektronik ▪ Përshkrimi ▪ Kodit, tipin e lëndës, kreditet ▪ Gjuha në të cilën zhvillohet mësimdhënia ▪ Objektivat ▪ Klasifikimi i lëndës në të detyrueshme apo me zgjedhje ▪ Tematikat dhe konceptet themelore që trajtohen duke u specifikuar sipas javëve ▪ Literaturën bazë, literaturën ndihmëse ▪ Orët në auditor dhe si punë individuale ▪ Mënyra e vlerësimit dhe e kontrollit të dijeve ▪ Rezultatet dhe kompetencat profesionale dhe teorike që fitohen nga kjo lëndë.
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit bën një rishikim të përvitshëm të syllabuseve para fillimit të vitit shkollor. Në shembullin e dhënë në dosjen e dokumentacionit për vlerësimin e brendshëm evidentohet një procedurë e ndjekur në 10/102018 për rishikimin e syllabuset. Në ëorkshopin e organizuar kanë marrë pjesë i gjithë departamenti i Shkencave të Komunikimit. Ëorkshopi drejtohet nga përgjegjësi i departamentit. Në këtë shembull, por edhe nga diskutimi dhe takimi online me stafin e departamentit është treguar kujdes në përditësimin e temave, të literaturës dhe që të mos ketë përsëritje të temave nga njëra lëndë në tjetrën, ose të ndryshojë këndvështrimi i tematikave të trajtuara.</p> <p>Syllabuset mësimore janë hartuar duke u bazuar në eksperiencat e universiteteve të huaja, si edhe në sajë të bashkëpunimit me dy universitetet në Rumani dhe Kroaci.</p> <p>Gjithashtu për përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve apo tematikave të trajtuara si edhe mësimdhënies në tërësi, shërbejnë edhe informacioni i marrë nga pyetësorët/anketimi që bëhet çdo vit me studentët.</p> <p>Gjatë vitit 2020, për arsye të situatës me pandeminë Covid 19 KU BEDER ka organizoi një pyetësor të veçantë “Anketë e posaçme në kushtet e pandemisë “Mësimi në distancë – online” ku është marrë opinioni i studentëve për</p>




	<p>mundësitë dhe vështirësitë e kësaj forme të re të mësimin online. Kjo ka sjellë përditësime të mënyrës së kontrollit të dijës/vlerësimit (për disa nga lëndët, nga tre teste u bënë 2 teste, gjatë periudhës në mes të semestrit)</p> <p>I gjithë informacioni i nevojshëm për ndryshimet në syllabuse dhe në pjesë të programit, dokumentohet dhe ruhet pranë Departamentit.</p> <p>Gjatë hartimit të këtij raporti në faqen online të KU BEDER gjendet edhe thirrja për aplikime në kuadër të programit Erasmus, për mobilitetin e studentëve dhe të stafit.</p> <p>https://www.beder.edu.al/sh/nees/student/thirrje-per-aplikime-/1639</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”;</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4									
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.									
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” zgjat tri vite akademike, të ndarë në gjashtë semestra. Viti akademik ka 32 javë mësimore në auditor dhe një semestër ka 16 javë mësimore në auditor.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar me sistemin e Kartës së Bolonjës dhe përmban gjithsej 180 ECTS. Kreditet janë të shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe një vit akademik ka 60 ECTS. Për përcaktimin e krediteve është respektuar norma e vendosur 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. I gjithë informacioni është i përcaktuar në Rregulloren e Programit mësimor.</p>								
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka në tërësinë e tij 36 lëndë ku përfshihen 3 lëndë me zgjedhje, praktika profesionale dhe punimi i diplomës. Hartimi i këtij programi mësimor është mbështetur edhe në praktikat e disa universitete të SHBA, nga eksperiencia që drejtuesi i departamentit ka pasur, nga diskutimet brenda departamentit për lëndët që do të përfshihen si edhe nga eksperiencia dhe bashkëpunime me Universitetin në Kroaci dhe në Rumani me të cilët kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><u>Në vitin e parë akademik janë lëndët:</u></p> <table border="1"> <tr> <td>1. Gjuhë shqipe I</td> <td>7. E drejta publike Gjuhë e huaj I</td> </tr> <tr> <td>2. Gjuhë shqipe II</td> <td>8. Gjuhë e huaj II</td> </tr> <tr> <td>3. Hyrje në Sociologji</td> <td>9. Hyrje në Informatikë</td> </tr> <tr> <td>4. Hyrje në komunikim masiv,</td> <td>10. Teoritë e komunikimit</td> </tr> </table>	1. Gjuhë shqipe I	7. E drejta publike Gjuhë e huaj I	2. Gjuhë shqipe II	8. Gjuhë e huaj II	3. Hyrje në Sociologji	9. Hyrje në Informatikë	4. Hyrje në komunikim masiv,	10. Teoritë e komunikimit
1. Gjuhë shqipe I	7. E drejta publike Gjuhë e huaj I								
2. Gjuhë shqipe II	8. Gjuhë e huaj II								
3. Hyrje në Sociologji	9. Hyrje në Informatikë								
4. Hyrje në komunikim masiv,	10. Teoritë e komunikimit								

5. Hyrje në marrëdhënie publike

11. Reklama dhe promovimi

6. Bazat e Marketingut

12. E drejtë biznesi

Siç shikohet nga emërtimi dhe nga shfletimi i syllabuseve të secilës nga këto lëndë, ato janë të përshtatshme për të dhënë bazat e njohurive teorike dhe disa informacione hyrëse për lëndët e profilit që do të bëhen në vitet e tjera akademike.

Në vitin e dytë akademik janë lëndët:

13. Metodatat e kërkimit dhe shkrimit akademik

19. Mediat e reja

14. Teknikat e shkrimit në komunikimin e integruar

20. Menaxhim i marrëdhënieve me klientin

15. Histori e Shqipërisë

21. Teknologjitë e Informacionit

16. Bazat e Semiotikës

22. Statistikë për shkencat sociale

17. Parimet e menaxhimit

23. Menaxhim eventesh

18. Marketing dhe marrëdhënie publike online

24. Lënda me zgjedhje (Komunikim Biznesi, Tregtia online, Sfidat aktuale në marketing, Arti i fotografisë)

Lëndët e vitit të dytë akademik vendosin baza më të fuqishme për profesionin dhe krijojnë aftësitë profesionale duke i çuar ato në një nivel më të lartë.

Në vitin e tretë akademik janë lëndët:

25. Multimedia

31. Punimi i diplomës

26. Studim tregu

32. Audiencat

27. Etika e medias dhe legjislacioni

33. Strategji kreativiteti

28. Marketing strategjik

34. Menaxhimi i markës

29. Praktike profesionale

35. Lënda me zgjedhje (Komunikim politik, Menaxhim krizash, marketing me pakicë, E folura në publik, Zhvillimi i produktit të ri, Menaxhim projekti, Bazat e teorive të përkthimit, Intervistimi, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore)

30. Lënda me zgjedhje (Komunikim Vizual, Komunikim Organizativ, Komunikim Ndërkombëtar, Hyrja në shkencat politike, Komunikim Vizual ndërkulturor dhe ndërpersonal, Historia e integritimit dhe institucionet e BE-së)

Sikurse vërehet, në vitin e tretë është edhe praktika profesionale që e ndihmon dhe e përgatit studentin si për hartimin e punimit të diplomës edhe për njohjen e terrenit dhe përgatitjen për karrierën e ardhme, pas diplomimit.

Viti II, por sidomos viti i III, sjellë ballafaqimin e koncepteve teorike dhe përshtatjen e tyre me praktikën. Pjesa më e madhe e programit mësimor (kurrikular dhe extra-kurrikular) i dedikohet aftësisë praktikë nëpërmjet praktikave profesionale në punë konkrete në profesion. Kjo realizohet si në orët në auditor edhe në detyrat e kursit dhe aktivitetet sociale të organizuara. Studentëve u jepet mundësia edhe e pjesëmarrjes në internship/praktikave profesionale në kompani, agjenci, media, institucione, etj. Kjo realizohet edhe gjatë periudhës së verës të cilat i shërbejnë përfundimit të aftësive praktikave nga ana

	e studentëve. Ka pasur shembuj edhe të punësimit të përkohshëm pranë këtyre kompanive të studentëve.
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Sipas Rregullores së programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ndarja e bërë në lëndë module dhe kreditet përkatëse respekton sistemin e Kartës së Bolonjës. Përveç klasifikimit të lëndëve dhe ndarjes së tyre në orë seminaresh, leksionesh, dhe krediteve respektimi, programi i studimit jep edhe ndarjen e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë. Raporti i ndarjes së veprimtarisë formuese të planit mësimor të programit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” sipas kategorive janë si më poshtë:</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>A. Lëndët Bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme - përbëjnë 17.78% të totalit të krediteve të programit të studimit; (intervali i lejuar 15-20%)</p> <p>B. Lëndët Karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore - përbëjnë 53.33% të totalit të krediteve të programit të studimit; (intervali i lejuar 50-55%)</p> <p>C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje - përbëjnë 14.44% të totalit të krediteve të programit të studimit; (intervali i lejuar 12-15%)</p> <p>D. Lëndë Plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale përbëjnë 11.11% të totalit të krediteve të programit të studimit; (intervali i lejuar 10-15%)</p> <p>E. Detyrimet Përmbyllëse - përbëjnë 3.33% të totalit të krediteve të programit të studimit. (intervali i lejuar 3-5%)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit Bachelor. Ajo është ndërtuar bazuar si në përvojën e stafit akademik, përvojën e Departamentit dhe anëtarëve të tjerë PAK në këtë departament. Struktura mbart edhe eksperiencën të universiteteve të huaja.</p> <p>Plani mësimor ka të ndërthurura elementët e teorisë dhe praktikës profesionale të studentëve, nëpërmjet lëndës së praktikës apo internshipeve. Departamenti organizon edhe aktivitete / seminare konferenca / workshope (kurrikulare apo edhe jashtë kurrikulare). Në raportin vjetor janë të renditura disa aktivitetet si:</p> <p><u>Veprimtari Akademike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Workshop 11 shkurt 2020 – “Sfidat dhe përparësitë e turizmit të brendshëm në Shqipëri” ▪ Seminaret MARCOM ▪ Seminaret “Studenti dhe profesioni” (9 aktivitete të tilla të organizuara 2019-2020) <p><u>Aktivitetet Sociale:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Klubi i debatit ▪ Trajnime

	<p><u>Projekte:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Fushata “Njih tokën tënde, vizito Shqipërinë” ▪ Projekti: “Roli dhe efekti i memeve tek audienca shqiptare” <p>Pas vitit të parë struktura e programit i kushton më shumë ore mësimore dhe ngarkesë lëndëve që janë specifikuara të profesionit.</p> <p>Klasifikimi dhe ndarja e tillë e lëndëve përputhet me kërkesat ligjore dhe lehtëson transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve.</p> <p>Gjatë lëndës Praktika Profesionale, studentët përfshihen rregullisht në praktikën e tyre në kompani, agjenci, organizatë ose institucione private dhe publike. Në përfundim ata paraqesin dëshmi të pjesëmarrjes dhe angazhimit si parakusht për përfundimin e lëndës dhe diplomimin në fund të programit. Studentët kanë edhe mundësinë e pjesëmarrjes në praktika verore të organizuara nga Departamenti në bashkëpunim me kompani, agjenci, ndërmarrje, organizata dhe institucione me të cilat janë lidhur marrëveshje.</p> <p>Të gjitha këto pasurojnë programin e studimit, duke realizuar objektivat formuese, dhe aftësuar studentët për tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Ky program studimi është i ri dhe ky vit është viti i parë i të diplomuarve. Programi ka vetëm tri vite që është hapur.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik pedagogu i lëndës hedh në sistemin informatik Bedër Information System (BIS) programin e lëndës që jep bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe ndihmëse. Programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit në fillim të çdo viti akademik realizon ëorkshop për përditësimin e syllabuseve me anëtarë të këshillit të departamentit. Në këto ëorkshop analizohen syllabuset e lëndëve, diskutohen mënyrat për përditësimin e syllabuseve të lëndëve, shkëmbehet eksperiencia mbi metodat e mësimdhënies dhe diskutohet për literaturat plotësuese.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programit dhe lendeve në programin e të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka të përfshirë përvojat e mira të huaja dhe vendase duke e lidhur edhe me nevojat e tregut për specialistë në këtë profesion. Njohuritë teorike dhe përshtatja e tyre me eksperiencat praktike i ndihmon studentët që të integrojnë mirë konceptet e fushës së marketingut duke garantuar përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Ky program dhe studimet e mëtejshme në këtë fushë mund të thellohen nga programet e ciklit të dytë Master që KU BEDER ofron si Master Shkencor me profil marrëdhënie me publikun, ashtu edhe master profesional në Komunikim Marketingu.</p> <p>Natyrisht, struktura dhe programi Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” lejon mundësinë edhe të transferimit të studimeve në ILA të tjera.</p>

<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka lidhur marrëveshje si për praktikat mësimore ashtu edhe për internship verore që organizohen me studentët. Disa nga partnerët kryesorë në fushën e PR janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Landmark ▪ New Media Comunication ▪ Source One ▪ Iceberg Communication ▪ DDB Albania ▪ Instituti Shqiptar i Medias ▪ Karrota ▪ Neë Digital Media <p>Paralelisht Departamenti bashkëpunon edhe me organizata të tjera si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Agjencia Vatra ▪ Albsig ▪ ABC neës ▪ Vizion Plus ▪ Klan TV ▪ Klan Plus ▪ Tema TV ▪ Neës 24 ▪ Report TV ▪ RTV Ora <p>Të gjitha këto organizata i japin mundësi edhe për të njohur terrenin mediatik dhe nevojat e tregut të punës. Departamenti ka realizuar edhe një rivlerësim të tregut të punës duke studiuar në mënyrë të detajuar tregun. Studimi ka disa elementë si për mundësitë e punësimit, po ashtu edhe pritshmëritë që tregu i marketimit në epokën digjitale ka për profesionistët e dalë nga studimet arsimore. Studimi u realizuar nga Departamenti me përfshirjen dhe mbështetjen e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. Departamenti i është vazhdimisht në marrëdhënie me partnerët e ndryshëm në fushën e komunikimit, biznesit, mediatikë, dhe atë institucional dhe tregun e punës në përgjithësi. Kjo i shërben si përditësimit të lëndëve ashtu edhe hapjes së moduleve/lëndëve apo programeve të reja studimore.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”;</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite</p> <p>Evidenca nr. 37: Shembull ëorkshopi për përmirësimin e syllabuseve;</p> <p>Evidenca nr. 84 Përshkruesit e Niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” si edhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.5 Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” kanë</p>

angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

kualifikimin e përshtatshëm sipas kërkesave ligjore në fuqi. (Bazuar në tabelat 1-7 të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm)

Programi i studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, Personali Akademik Efektiv (PAE) dhe Personali Akademik me Kontratë (PAK):

Të dhënat për stafin e programit	Viti 2018-2019		Viti 2019-2020		Viti 2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr						
Prof. Assoc.	1		1		1	
Dr/PHD	2		6	1	6	1
Msc	4	2	4	4	7	4
Total	7	2	11	5	14	5

Raporti midis stafit akademik efektiv dhe stafit akademik me kontratë për programin Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është si më poshtë:

PAE/PAK për vitin 2018-2019: 7/2

PAE/PAK për vitin 2019- 2020 11/5

PAE/PAK për vitin 2020-2021 14/5

Përlllogaritja e mësipërme përfshin lektorët dhe asistent lektorët.

Përsa i takon ngarkesës mësimore (në orë) midis PAE dhe PAK këto raporte janë:

Viti akademik	% e ngarkesës mësimore e realizuar nga PAE
2018-2019	87 %
2019-2020	82%
2020-2021	89%

Siç shikohet edhe nga raportet e mësipërme, orët mësimore të zhvilluar nga PAE ndaj orëve mësimore në total kanë qenë gjithnjë ato që kanë mbajtur ngarkesën kryesore, duke kryer mbi 80% të ngarkesës mësimore.

Ngarkesa e pedagogëve PAE luhetet nga 140 ore - 448 orë duke përfshirë këtu si orët mësimore në programin Bsc, Msc dhe MP dhe orë të tjera. Kjo ngarkesë për disa pedagogë është e lartë (siç është rasti i pedagoges me 448 orë mësimore gjatë vitit).

Ndërsa nëse do të llogarisim totalin e orëve edhe në programet e tjera, janë 7 pedagogë nga stafi i PAE që e tejkalojnë shifrën prej 260 të orëve mësimorë.

[Evidenca nr. 20; Udhëzim Për ngarkesën mësimore;](#)

[Shtojca 1 tabelat 1- 4](#)

[Shtojca 1 tabelat 12](#)

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të

Duke analizuar CV e personelit akademik si me kohë të plotë edhe me kohë të pjesshme, vërehet se niveli i kualifikimit, drejtimi i tyre profesional dhe eksperiencia në angazhimin e moduleve mësimore përshtaten me profilin e lëndëve që ato japin në program.

<p>kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Lektorët kryesore të lëndëve janë në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës.</p> <p>Stafi akademik me kontratë, është një vlerë shtuar për programit, pasi këto programe studimi kanë specifika të veçanta dhe kjo sidomos për grupet e lëndëve profesionale për të cilat ekspertiza nevojitet të jetë edhe nga fusha praktike.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit, i cili është edhe koordinatori i programit të studimit, ka gradën Dr. dhe me një përvojë të gjatë akademike. Gjithashtu ai është figurë publike si analist në disa media kombëtare, duke i dhënë një dimension të ri dhe duke gërrshetur dy përvoja si atë akademike dhe mediatike. Këto e ndihmojnë më tej, për të pasuruar mësimdhënien edhe me elementë të zhvillimeve aktuale në tregun mediatik shqiptar. Edhe anëtarët e tjerë të stafit kanë tituj dhe grada shkencore. Ka ardhur në rritje numri i stafit me gradën Dr. Dhe me lart. Kështu në vitin aktual mësimor 2020-2021 rreth 42% e stafit akademik efektiv/me kontratë kanë gradën Dr dhe me lart.</p> <p>Evidenca nr. 15: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Shtojca 1 tabelat 1- 4</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>KU BEDER ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me organizata të medias në vend të cilat i mundësojnë studentëve organizmin e praktikave profesionale. Të tilla marrëveshje janë nënshkruar me “Neë Media Communication”, “Neë Medi Digital”, “Iceberg Communication”. Këto kompani janë nga më të spikaturat në marketing dhe kjo i ndihmon studentët të marrin eksperiencën e punës reale dhe të krijojnë aftësi për të përshtatur me tregun e punës.</p> <p>Në zbatim edhe të rregullores së organizimit administrativ, KU BEDER ka një zyrë të këshillimit të karrierës. Kjo zyrë është përgjegjëse për organizmin e veprimtarive që kanë për qëllim të afrojnë studentët me tregun e punës si me institucione ne sektorin publik, ashtu edhe me biznese ne sektorin privat.</p> <p>Secili departament zgjedh një këshilltar karriere në fillim të çdo viti akademik. Ky është një pozicion shumë i rëndësishëm për vendosjen e kontakteve të studentit me praktikën reale dhe zgjeron mundësitë e punësimit.</p> <p>Praktika Profesionale mbikëqyret nga një anëtar i stafit në vendin e punës ku zhvillohet praktika, po ashtu edhe nga anëtari i caktuar i stafit akademik të departamentit. Lënda e praktikës profesionale realizohet nga 3 lektorë (staf akademik) për çdo klasë mësimore me një ngarkesë 8-10 studentë për një lektor, i cili kryen rolin e këshilluesit dhe orientuesit por edhe mbikëqyrësit të procesit të praktikës profesionale në bashkëpunim me kompanitë ose institucionet përkatëse ku janë angazhuar studentët për realizimin e praktikës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Nga natyra e programit të studimit për mediat dhe shkencat e komunikimit, nuk ka laboratorë të mirëfillta. Edhe për lëndët praktike që janë të lidhura ngushtësisht me profesionin ato janë një ndërthurje e pjesës teorike me atë praktike. Shkencat e komunikimit realizohen më drejtpërdrejtë me teknologjitë e reja, dhe të gjitha platformat e komunikimit. Kjo ndihmon edhe për ti përgatitur studentët që ata të përdorin të gjitha format e teknologjive në realizimin e marketimit dhe komunikimit me publikun.</p> <p>Gjatë dy viteve të fundit, e ndikuar nga situata e pandemisë Covid-19, janë përdoruar format dhe teknologjitë e komunikimit në distancë për ti dhënë mundësi studentëve të komunikojnë jo vetë për të marrë pjesë ne leksione por edhe për realizimin e detyrave të kursit.</p>




	<p>Departamenti ka të pajisur studio me kompjuter dhe lidhjen në internet si edhe angazhon personel ndihmës mësimor, në varësi kërkesave të pedagogëve.</p> <p>Laboratorët e kompjuterëve, lidhja e Internetit, organizimi, përdorimi dhe përditësimi i software të nevojshëm për programin e studimit mirëmbahen nga personeli administrativ përkatës nën përgjegjësinë e Zyrës së IT.</p> <p>Studentët përdorin për arsye të praktikave profesionale edhe portalin informativ www.objektiv.al Tek ky portal demonstrohen edhe teknika të ndryshme të marketimit dhe komunikimit duke i bërë disi studentët edhe pjesë të redaksisë së këtij portali.</p> <p>Në realizimin e aktiviteteve jashtëkurikulare, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, bashkëpunon me Departamente të tjera të Fakultetit dhe KU BEDER duke bashkëpunuar sipas nevojave edhe me personel ndihmës akademik në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>KU BEDER ka hartuar një “Rregullore për funksionimin dhe organizmin e Komisionit të Përhershme për garantimin e standardeve dhe cilësinë”. Kjo rregullore përcakton detyrat e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Në këtë rregullore janë të përcaktuara format e mësimdhënies sipas programeve dhe lëndëve të ndryshme. Garantimi i standardeve të cilësisë në nivel institucional është e lidhur edhe me grupin tjetër të rregulloreve që lidhen me çdo program të veçantë studimi.</p> <p>Në situatën e pandemisë Covid-19, dhe pas organizmit të pyetësorit për kushtet e pandemisë KU BEDER ka aprovuar edhe rregulloren e mësimdhënies në distance për t’ju përshtatur më mirë kushteve të reja aktuale për ruajtjen e shëndetit të studentëve dhe pedagogëve.</p> <p>Në dokumentet e përcjella gjendet edhe propozimi për trajnime që Njësia për Sigurimin e Brendshëm për Cilësisë i kërkon Burimeve njerëzore për të</p>

	<p>zhvilluar trajnime për: (i) përdorimin e Google classroom; dhe (ii) Leksion i hapur për formën e zhvillimit të leksionit në një orë online. Sipas kalendarit të trajnimeve të organizuar me stafin, ka pasur tematika të ndryshme trajnime në përputhje me kërkesat e nevojat e stafit. Gjatë viteve 2019-2020 janë zhvilluar trajnime si: (i) përditësimi i syllabuseve – shtator 2019; (ii) përdorimi i platformës one.beder.edu.al – prill 2020; (iii) Rregullat e përgjithshme mbi menaxhimin e procesit të mësimdhënies – maj 2020; (iv) Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë – tetor 2020.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Struktura përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies e programit të studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” është Departamenti. Ndërsa në nivel institucional garantimi i cilësisë vlerësohet në mënyrë të rregullt nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC.</p> <p>KU BEDER organizon çdo vit anketa në përputhje edhe me “Rregulloren e anketave dhe vlerësimeve”. Rregullorja ka të përcaktuar hapat për secilin nga anketimet, qëllimet, afatet kohore dhe procedurat e komunikimit të rezultateve të anketimit.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik realizohet nëpërmjet (i) Anketa vetë vlerësuese e stafit akademik dhe (ii) Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik.</p> <p>(i) Anketa vetë vlerësuese e stafit akademik, e cila plotësohet nga personeli akademik dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës në fund të çdo viti një ndër qëllimet e ka edhe për të njohur progresin e stafit akademik dhe të përcaktojë treguesit e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe publikime.</p> <p>(ii) Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik merr informacion nga studentet në lidhje me cilësinë dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik, vlerësimin të dijeve ndaj studentëve të këtij institucioni. Anketa plotësohet nga studentët për çdo lëndë dhe pedagog, përbëhet nga nëntë pyetje me 5 mundësi zgjedhjeje secila. Anketimi me studentët zhvillohet 2 herë në vit, në përfundim të semestrit.</p> <p>NJSBC, gjatë kësaj periudhe pandemie Covid-19 zhvilloi një anketë të veçantë me studentët, në vitin 2020, me anë të të cilës synohej të kuptoheshin vështirësitë dhe problematikat e studentëve për të ndjekur procesin e mësimin online në kushtet e karantinës me qëllim përshtatjen e këtij procesi sa më pranë nevojave të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimin të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Siç u përshkrua më lart III.3.1 Kriteri 2, çdo semestër studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndës. Pyetjet synojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Kërkesat në pyetësor lidhen me (i) përpikmërinë e pedagogëve; (ii) përgatitjen e lëndës; (iii) zotërimin e njohurive të lëndës; (iv) materialin e lëndës; (v) ndërveprimin me studentët; (vi) metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e performancës së studentëve, menaxhimi i kohës. Në fund të pyetësorit ka edhe një pyetje e hapur, për sugjerimeve për lëndën dhe metodat e mësimdhënies.</p>

	<p>Një tjetër pyetësor ku tërhiqet mendimi i studentëve është ai që lidhet me vlerësimin e studentëve ndaj institucionit në tërësi. Ky anketim ka 20 pyetje dhe përfshin të gjitha aspektet e zhvillimit institucional.</p> <p>Nga pikëpamja institucionale, komentet dhe opinionet e studentëve mund të shprehen edhe nëpërmjet kontaktit me zyrën e dekanit të studentëve dhe të zgjedhur në këshillin studentor.</p> <p>Sipas rregulloreve të programit të studimit, departamentit dhe fakultetit, kur një student ka ankesa ndaj rezultatit të një testimi ose detyre, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim te zyra e sekretarisë mësimore. Ankimi shqyrtohet nga komisioni i cili ngrihet me vendim të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve që zhvillohen në KU BEDER përpunohen të ruajnë një balancë midis të drejtës së privacisë dhe publikimit të rezultateve.</p> <p>Anketimet individuale, për çdo pedagog, i bëhen publike vetëm pedagogut (me zarf të mbyllur) dhe përgjegjësit të departamentit.</p> <p>Rezultatet e përgjithshme të anketimeve, pa specifikuar emërtimet e pedagogëve, publikohen në faqen zyrtare të KU BEDER dhe janë pjesë e Raportit Vjetor të përgatitur për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Sipas kalendarit të trajnimeve të organizuar me stafin, tematikat e ndryshme të trajnimit lidhen me kërkesat e nevojat e stafit. Gjatë viteve 2019-2020 janë zhvilluar trajnime si: (i) përditësimi i syllabuseve – shtator 2019; (ii) përdorimi i platformës one.beder.edu.al – prill 2020; (iii) Rregullat e përgjithshme mbi menaxhimin e procesit të mësimdhënies – maj 2020; (iv) Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë – tetor 2020.</p> <p>Rezultatet e anketimit përdoren për të promovuar ato metoda mësimdhënie dhe vlerësimet më të mira që jepen nga studentet dhe nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, stafi është i përfshirë edhe në projekte të ndryshme ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve ndër-institucionale me universitete apo organizata të tjera.</p> <p>Raporti Vjetor i Departamentit përmban informacion të detajuar mbi aktivitetet e zhvilluara.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 17: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Evidenca 21: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standarteve të cilësisë. Evidenca 24: Anketa e vlerësimit të e mendimit të studentëve ndja institucionit Evidenca 30: Rregullorja për funksionin dhe organizmin e NjSBC Evidenca 35: Raporti Vjetor I Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2018-2019</p>

	Evidenca 36: Raporti Vjetor I Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2019-2020			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka të përcaktuar edhe elementët që përdoren në mënyrë të përgjithshme si metoda të mësimdhënies dhe transmetimit të njohurive. Po kështu edhe syllabuset e lendeve japim të përcaktuara qartë format konkrete për të nxitur studentet në të kuptuarin aktiv të lëndëve.</p> <p>Këto elementë janë leksionet, seminarat, ushtrimet, praktikatat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, projekte, etj. Raportet e përdorimit të secilës formë përputhen me legjislacionin dhe sistemin e krediteve, por kanë pak variacion nga një lëndë në tjetrën. Kjo bën dallimin tek lëndët që kanë më shumë bazë teorike me ato që kanë më tepër detyra kursi dhe punime në grup.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit organizon për studentet e tij edhe vizita, leksione të hapura me të ftuar nga fusha të ndryshme që lidhen me programin e studimit, konferenca ose ëorkshope në mënyrë që të mbështesë procesin e mësimor. Sipas Raportit Vjetor të Departamentit, janë zhvilluar vizita të grupeve studentore në agjenci marketingu në Shqipëri dhe Kosovë, si: <i>Agjencia Karrota-Prishtinë, Kosovë, Agjencitë McCan Tirana, Ladmark communications, Source One, Ministria e Komunikimit, etj.</i></p> <p>Po kështu edhe praktikatat profesionale që zhvillohen në vitin e tretë të studimeve janë një përvojë e mirë për studentët. Kjo realizohet falë marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara midis KU BEDER institucioneve të tjera.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve pasqyrojnë llojshmërinë e formave të mësimdhënies dhe mundësi të dhënies së njohurive dhe komunikimit me studentët.</p> <p>Për të respektuar diversitetin e studentëve, institucionalisht përdoren disa forma për thithjen e opinionit dhe mendimit të studenteve, me anë të pyetësorëve, duke i bërë ata pjesëmarrës në këshillat e departamentit.</p> <p>Programi i studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” nga vetë natyra e programit mësimor është i lidhur me punët individuale dhe në grup të studenteve duke i dhënë lirishtëri krijimtarisë së tyre në punët e kursit dhe duke ofruar bashkëpunime të profilizuara midis studentëve dhe pedagogëve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e</p>	<p>KU BEDER organizon dhe mbështet kualifikimin profesional të stafit akademik. Sipas një procedure të përcaktuar dhe me miratim të Dekanatit dhe</p>

<p>kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Senatit Akademik, pedagogët mbështeten në përpjekjet e tyre për të marrë pjesë në konferenca, seminare dhe për të avancuar në tituj dhe grada shkencore.</p> <p>Gjithashtu institucioni i kushton rëndësi përmirësimit të infrastrukturës së nevojshme si dhe realizon trajnime për personelin akademik në funksion të përmirësimit të metodave didaktike. Kjo u bë më tepër e nevojshme në dy vitet e fundit kur mësimi kaloi online dhe KU BEDER (si edhe ILA e tjera) u përshtat me këtë proces. Edhe përpara periudhës së pandemisë Covid-19 KU BEDER zhvillonte një pjesë të orëve mësimore në formatet e reja, duke përdorur Google classroom e për t'ja përshtatur objektiveve formues, nevojave të studentëve dhe mënyrave të reja formimit.</p> <p>Departamenti/ KU BEDER ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani mediatike të rëndësishme në tregun shqiptar, bashkëpunon me ta për të zhvilluar praktikat mësimore dhe për të përshtatur informacionin e dhënë me atë që kërkohet nga punëdhënësit dhe tregu i punës.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” dhe përgjithësisht programet e Departamentit të Komunikimit kanë një veçanti të programeve të tyre, pasi ndërlidhin mjaft mirë informacionin teorik me atë praktik. Kjo ndërlidhje vihet re edhe në CV-të e stafit. Anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të plotësuar objektivat e programit. Në personelin akademik ka lektorë me formim në fushën e komunikimit, marketingut, marrëdhënieve me publikun dhe medias. Ata kanë kualifikim si në universitetet brenda vendit ashtu edhe në universitete jashtë.</p> <p>Përgjegjësi i Departamentit, përveç formimit akademik brenda dhe jashtë vendit, ka edhe eksperiencën të drejtpërdrejtë në media, edhe në gazetari aktive edhe si figurë dhe analist në disa debate tematike për median. Lëndët e tij “Marrëdhënie publike” dhe “Teoritë e komunikimit” reflektojnë eksperiencën e tij shumë-planëshe. CV e pasura të stafit dhe vazhdimi i eksperiencës së punës në kompani mediatike apo marketimi i bëjnë ata shumë të përshtatshëm dhe kompetentë për të shpjeguar konceptet e ndryshme të këtij programi studimi. Lëndët e “Komunikim biznesi”, “Tregtia online”, “Komunikim vizual” “Strategji kreativiteti” jepen nga lektorë që kanë eksperiencë dhe i kanë ndërtuar ato profesione edhe në kompanitë e tyre të marketimit</p> <p>Krahas aktiviteteve akademike, Departamenti i ndërthur në planin mësimor edhe aktivitete sociale dhe fushata promovuese në mënyrë që studentët të jenë në qendër të një fushate të vërtetë marketimi dh të punojnë për të. Të tilla përmenden fushatat: (i) “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”; (ii) “Një fije floku për më shumë buzëqeshje”; (iii) “Një shtëpi, një mburojë për trashëgiminë kulturore”; (iv) “Një libër më shumë për Preshevën”; (v) “Ruaj traditën, festo shqip”; (vi) “Njih tokën tënde, vizito Shqipërinë”.</p> <p>Këto aktivitete të organizuara përshtaten edhe me mundësitë për të materializuar lëndët e realizuara në programin e studimit “Bachelor“ në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu“, si “Menaxhim Eventesh”, “Multimedia”, “Strategji Marketingu”, etj. Edhe stafi akademik angazhohet në mësimdhënie përmes një procesi dinamik të vlerësimit të njohurive, kompetencave dhe metodologjisë në mësimdhënie, i cili nis që me procesin e rekrutimit të tyre dhe vijon me kualifikimin e vazhdueshëm.</p>

<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Studentët janë të përfshirë në procesin e përmirësimit të metodave të mësimdhënies, përmes marrjes së opinioneve të tyre nga anketimet. Çdo semestër studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndës. Pyetjet synojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme në lidhje me lëndën dhe performancën e pedagogut. Kërkesat në pyetësor lidhen edhe ndërveprimin e pedagogëve me studentët si edhe metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së studentëve. Pyetësi ka një pjesë edhe për sugjerimeve të hapura për lëndën dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>Pyetësi ruan edhe anonimat e studentëve.</p> <p>Informacioni i marrë nga pyetësorët përdoren nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë edhe për organizimin e ëorkshop-eve dhe aktivitete të ndryshme trajnimi.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p>	<p>Nga syllabuset e lëndëve si edhe nga diskutimi me pedagogët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit në KU BEDER vihet re përdorimi i mënyrave të ndryshme dhe interaktive të komunikimit të pedagogëve dhe studentëve. Përveç seminareve dhe leksioneve ato përdorin edhe forma të ndryshme të punës në grup, pjesëmarrje në projekte, prezantime të punimeve të tyre studentore përpara audiencave të ndryshme, etj. Llojshmëria e metodave të interaktivitetit diktohet edhe nga lëndët praktike dhe nga natyra e programit të studimit që është specifike për shkencat e komunikimit dhe veçanërisht marketingun.</p> <p>Leksionet e hapura me të ftuar nga fusha të ndryshme publike apo të biznesit, si edhe prezantimet e studentëve, u japin atyre një tjetër dimension në mësimdhënie dhe të nxëniet e lëndëve. Një tjetër formë e përthithjes së dijeve janë edhe vizitat studimore të grupeve të studentëve të programit të studimit në agjenci, kompani marketingu, biznese , etj (Hotel Hilton Garden Inn – Tiranë, agjenci marketingu Karrota – Prishtinë, Source One – Tiranë, Ministria e Komunikimit, Landmark Communication, McCann Tirana, – Tiranë etj.)</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Të menduarit e pavarur dhe kritik të studentëve është edhe një nga objektivat procesin mësimor. Ky objektiv realizohet edhe më qartë praktikisht kur realizohen projekte, detyra kursi, prezantime, në të cilat studentët duhet të marrin vete vendimet në zgjedhjen produktit, fushatës apo tipit të komunikimit. Kjo i aftëson studentët të mendojnë në mënyrë të pavarur, si edhe të jenë të përgatitur për sfidat e së ardhmes.</p> <p>Në realizimin e projekteve / detyrave në grup studentët kanë autonomi në organizimin e punëve brenda grupeve të punës, por krahas kësaj edhe vlerësohen për kontributin e anëtarëve të grupit, në kritere të tillë si përfshirja, kontributi me ide të vlefshme, marrja e iniciativave, gatishmëria dhe realizimi i detyrave, bashkëpunimi dhe ndihma ndaj anëtarëve të grupit. Këto vlerësime përfshihen në vlerësimin e përgjithshëm të studentit për lëndën përkatëse.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; Evidenca 15: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit; Evidenca 17: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite Evidenca 21: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standarteve të cilësisë. Evidenca 24: Anketa e vlerësimit të e mendimit të studentëve ndaj institucionit</p>




	Evidenca 30: Rregullorja për funksionin dhe organizmin e NjSBC Evidenca 35: Raporti Vjetor I Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2018-2019 Evidenca 36: Raporti Vjetor I Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2019-2020			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>KU BEDER është i vendosur në mjedise të marra me qera për një kohë afatgjatë. Sipas Tabelës 16 të dosjes së vlerësimit të brendshëm, mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka një mjedis prej 2733.5 m². Kjo sipërfaqe llogaritet për një numër prej 603 studentesh të fakultetit duke rezultuar në mbi 4.5 m² për student.</p> <p>Institucioni ka salla për leksione, seminare për veprimtari promovuese dhe si edhe laboratorët për lëndët praktike të informatikës, sallat e internetit, bibliotekës, konferencave, mjedise të përbashkëta për holle, korridore. Gjithashtu ka edhe mjedise për aktivitetet sh lodhëse , kafeteri, fast food, mjedise sportive etj. KU BEDER ka internet në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin dhe bibliotekën.</p> <p>KU Beder në vitin akademik 2020-2021 ka lëvizur nga godinat e mëparshme në dy godina të reja, që janë të sapo rikonstruara dhe për mirëmbajtjen e tyre janë kontraktuar subjekte të tjera private.</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Sipërfaqja totale e dy godinave është 3594 m² dhe ka si mjedise të dedikuara për mësimdhënien, ashtu edhe ato për stafin dhe ambientet ndihmese dhe utilitare. Godinat kanë sistem ngrohjeje dhe janë të pajisura edhe me ashensorë. Sallat mësimore si ato të leksioneve dhe seminareve kanë ndriçim të mirë. Pjesa më e madhe e tyre është e pajisur edhe me videoprojektorë dhe “smart board” për të mundësuar zhvillimin normal të procesit mësimor.</p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	<p>I gjithë ambienti dhe kampusi i KU BEDER është i pajisur me Internet Personeli akademik dhe studentët kanë llogarinë e tyre të postës elektronike @beder.edu.al. Sistemin Interaktiv Bedër (BIS) të sistemit të brendshëm nga ku studentet mund të ndjekin notat e tyre, ndërsa stafi akademik e përdor për të dhënë informacione për studentet, përmbledhjet e leksioneve, detyrat etj. Gjithashtu, studentet dhe pedagogët mund të përdorin platforma elektronike me memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom, etj. Disa nga softuare që përdoren janë: MS Office, Adobe, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 e fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Ëorkbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + Vray, 3DMAX dhe SPSS.</p> <p>Platforma online G-SUITE me shërbimet përdoret realizimin e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Kjo u pa më e qartë edhe në semestrin e dytë të vitit të kaluar dhe gjatë vitit akademik 2020-2021. Gjithashtu, përmes G-Suite çdo pedagog ndan materialet e</p>

	leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e ndryshme dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	<p>Syllabuset e lëndëve përcaktojnë edhe literaturën e nevojshme për studentët. Ajo ndahet në literaturë të rekomanduar dhe literaturë të detyrueshme. Përmes bibliotekës së tij, institucioni vë në dispozicion një numër të konsiderueshëm të teksteve bazë dhe literaturë ndihmëse. Çdo vit krahas ëorkshope që bëhet për rishikimin e syllabuseve, rishikohet, përditësohet edhe literatura respektive e lendeve. Literatura është bashkëkohore dhe pasqyrohet në programet e lëndëve. Bazuar në kërkesat e stafit akademik, kjo literaturë zgjerohet dhe vihet në shërbim të studentëve. KU Bedër ka akses në një numër bibliotekash online. (trajtohet në kriterin 6)</p> <p>Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi. Biblioteka pasurohet vazhdimisht sipas kërkesave të pedagogëve për tekstet mësimore të detyrueshme. Një ndihmë në pasurimin e bibliotekës ka dhënë edhe një donacion në tituj librash për komunikimin i dhënë nga Ambasada e ShBA në Tiranë, në tetor 2018.</p> <p>Lidhur me programin e studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, një pjesë e mirë e literaturës është në anglisht dhe nuk është e përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo lidhet edhe me faktin se programet/software me të cilat punohen disa nga detyra konkrete të studentëve dhe punët në grup janë gjithashtu në anglisht. Pedagogët për të lehtësuar kuptimin përgatisin materiale të përshtatura në gjuhën shqipe.</p>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<p>Biblioteka e KU Bedër ka një numër prej rreth 26,000 titujsh për studentet. Gjuha e botimeve është kryesisht në shqip dhe anglisht, por ka literaturë edhe në gjuhe të tjera si frëngjisht, turqisht, italisht gjermanisht.</p> <p>Biblioteka funksionon nga e hëna në të shtunë, 8.30-19.00 dhe ofron mjedise komode për studimin dhe rishikim të materialeve. Biblioteka ka edhe Internet për të mundësuar kërkimin online.</p> <p>Klasifikimi i titujve në bibliotekë ndjek modelin e Librarisë së Kongresit edhe me sistem kodifikimi të librave.</p> <p>KU Bedër planifikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, sipas departamenteve, me anë të një fondi të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.</p> <p>Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e departamentit të Shkencave të Komunikimit, në kuadër të së cilës u mbledhën rreth 10.000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë. Për pasurimin e bibliotekës me rreth 318 libra ka kontribuar Ambasada e SHBA, dhe botimet e sjella ishin kryesisht të lidhura me shkencat e komunikimit.</p>
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të	KU BEDER ka platformën online@beder.edu.al që është pjesë e G-Suite dhe është në marrëveshje pa afat kohor të përcaktuar. Ajo përdoret për qëllim edukimi dhe u ofron përdoruesve një llogari në email.

<p>fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Po kështu KU BEDER ka edhe platformën online one@beder.edu.al, që përdoret për mësimdhënie dhe raportim online e cila është krijuar specifikisht për semestrin e pranverës dhe funksionon qe prej vitit akademik 2019-2020.</p> <p>Kërkimi i librave në bibliotekë mund të bëhet edhe nëpërmjet platformës JSTORE, cila mundëson përdorimin e mbi 12 milionë artikujve, librave dhe burimeve shkencore në 75 disiplina të ndryshme.</p> <p>Nëpërmjet http://www.jstor.org / ose me anë të llogarisë mail të institucionit, çdo anëtar i stafit të KU BEDER mund të hyjë në koleksionet e JSTOR.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” kanë mundësinë e shfrytëzimit të dy laboratorët kompjuterikë të cilat përdoren për realizimin e detyrave dhe projekteve. Këto laboratorë përdoren si nga studentët gjatë orëve të mësimit ashtu edhe për realizimin e detyrave përkatëse, por gjithnjë nën kontrollin dhe udhëheqjen e stafit përkatës akademik dhe ndihmës. Sallat dhe biblioteka, gjatë sezonit të provimeve funksionojnë edhe në fundjave. Gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 dhe vitin akademik 2020-2021 duke qene se mësimi është zhvilluar online, sallat janë shfrytëzuar vetëm në periudhën e konsultimeve që janë zhvilluar.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Siç u shpjegua në III.3. kriteri 6 KU BEDER ka platformën institucionale online G-Suite e cila ofron email, hapësirë pa limit drive, video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize online, detyra dhe vlerësime për këto. Kjo ishte shumë e nevojshme gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, duke siguruar vazhdimësinë e pandërprerë të procesit mësimor akademik në komunikimet e vazhdueshme dhe realizimin e seancave të procesit mësimor. Sistemi i email mundësohet si për stafin, ashtu edhe për studentët.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit i ka përdorur teknologjitë e reja edhe më parë, duke përdorur google classroom, duke i paraprirë mësimin online.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Siç u përshkrua më sipër, sistemet e komunikimit elektronik të brendshëm përdoren si nga studentët edhe pedagogët për të aksesuar leksionet, për të marrë rezultatet e provimeve, email etj.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Ky është vitit i parë që do të diplomohen studentët e programit të studimit Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”. Gjatë ditëve të takimeve online për vlerësimin e jashtëm, ishte koha kur do të fillonte përzgjedhja e temave të diplomave për këta studentë. Në fillim të semestrit të dytë në vitin e fundit secili student bën një përzgjedhje për temën e diplomës dhe propozon të punojë nën udhëheqjen e një anëtari të stafit akademik të departamentit, bazuar në disiplinën në të cilën ai dëshiron të kryejë punimin e diplomës.</p> <p>Sipas procedurave edhe në programet e tjera të studimit të nivelit Bachelor, caktohen 3 pedagogë të cilët luajnë rolin e udhëheqësit të diplomës për 5-7 studentë të programit. Pas caktimit të mbikëqyrësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit, duke filluar me</p>




	<p>zgjedhjen e temës, duke realizuar konsultime të vazhdueshme deri në përfundimin e punimit të diplomës.</p> <p>Informacioni përshkruhet edhe në syllabusin e lëndës “Punim diplome”. Lënda ka 6 kredite.</p> <p>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”;</p> <p>Evidenca 33: Udhezues i sistemit informativ BIS</p> <p>Evidenca 42: Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19;</p> <p>Evidenca 43: Marrëveshja për akses në JSTOR;</p> <p>Evidenca 60: Rregullore mbi marrjen e masave higjieno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe Covid-19</p> <p>Evidenca 63: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës</p> <p>Evidenca 102: Kontrata me Albpastrim</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>KU BEDER ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Krahas saj është ndërtuar edhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, i cili është organ kolegjal që ka si funksion kryesor garantimin e cilësisë së programeve të studimit dhe cilësisë së institucionit. KU BERDER ka një rregullore të miratuar për këtë Komision. Bazuar në të, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale ka në përbërje si anëtarë të brendshëm të institucionit ashtu edhe anëtarë të jashtëm. Komisioni shtrihet në nivel institucional dhe zgjidhet nga Senati i KU BEDER. Ndër përgjegjësitë kryesore të këtij Komisioni janë edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Organizimin e një rrjeti cilësie të brendshëm; ▪ Nxitjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet njërive; ▪ Zhvillimin e procesit të nxënies në tre hapa: mëso, apliko, shpërndaj; ▪ Riorganizimin e aftësive specifike në institucion; ▪ Promovimin e ideve inovatore me qëllim zgjidhjen e problemeve; ▪ Matjen dhe evidentimin e përmirësimeve në arritjen e cilësisë; ▪ Sigurimin e cilësisë; ▪ Analizimin e raporteve të përvitshme që vijnë nga çdo njësi rreth aktiviteteve të kryera, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; ▪ Auditimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Veprimtaria e Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale si edhe e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë shtrihet edhe në nivel departamenti. Fakulteti dhe departamenti kanë anëtarë të stafit të tyre akademik në përbërje të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Për të gjitha këto organizma ka rregullore të posaçme funksionimi që përcaktojnë qartësisht detyrat e tyre dhe lidhjen me fakultetet dhe departamentet. Institucioni kryen disa anketime me studentët çdo semestër si edhe me pedagogë. Informacionet janë të mundshme për tu aksesuar online.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit është gjithnjë në mbështetje të përdorimit të metodave të reja të mësimi, dhe kjo është e lidhur edhe me natyrën inovative dhe aspak të ngurtë të programeve të studimit që ofrohen. Lëndët e medias janë gjithnjë në ndryshim duke ju përshtatur edhe zhvillimeve aktuale në tregun mediatik kombëtar dhe ndërkombëtar. Metodave të reja të mësimdhënies përfshijnë si përdorimin e teknikave të reja, sidomos atyre online për t'iu përshtatur zhvillimeve, si edhe organizimin e punëve në grup, prezantime, ëorkshope, leksioneve të hapura, aplikime studimore, ndërveprimet me të ftuar nga industria mediatike vizita në terren, aktivitete vullnetare, projekte, klubet studentore, etj.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Pas realizimit të vizitës dy ditore në institucion (online), nga ndjekja në rrjetet sociale u konstatua riformatimi dhe rifunksionimi i sallës së medias, për të shërbyer më mirë studenteve duke përdorur edhe teknologjitë e reja. Këto mbështesin metodat inovative të mësimdhënies.</p> <p>Departamenti ka një bashkëpunim shumë të mirë me IT e KU BEDER për të mundësuar përdorimin e teknikave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie.</p> <p>Sikurse u informuan edhe në takim me zyrën e Burimeve Njerëzore, personeli akademik dhe ndihmës merr pjesë në seanca kualifikimi, përfshihet në projekte si kombëtare edhe rajonale, konferenca, etj.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë kanë të detajuara listën e trajnimeve për personelin akademik. Në listën dhënë në dokumentacion përfshin mbi 29 trajnime të tematikave të ndryshme, ku pjesën më të madhe të tematikave e zënë ato të lidhura me “Strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies” si edhe në këto dy viteve e fundit përdorimi i platformave online dhe i mësimdhënies në distancë. Kjo është ndikuar jo vetëm nga kushtet e pandemisë Covid -19 por edhe nga nevoja e përshtatjes së tendencave të reja në metodat bashkëkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kërkimore-shkencore.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit është njësia bazë për zhvillimin e këtij programi studimi. KU BEDER ka një bazë të mirë aktesh nënligjore si “Plani strategjik i zhvillimit 2018-2023 dhe statuti i ndërtimit të KU BEDER të cilët saktësojnë se stafi akademik i programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” dhe stafi mbështetës (koordinatorja e Departamentit, Zyra e Administratorit të Fakultetit, etj.) janë përgjegjës për zbatimin e duhur të programit të studimit dhe janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Metodat e ndryshme të mësimdhënies, përveç leksioneve dhe seminareve përfshijnë edhe vizitat, takimet ortë e hapura prezantimet drejt audiencave të</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës</p>	

<p>akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitet përgjegjëse.</p>	<p>reja, kryesisht tregut apo në ambientet e ndryshme të punës, atje ku nesër të diplomuarit e këtij program do të punojnë.</p> <p>Analizimi i këtyre metodave të reja, ndërthurja e tyre me metodat tradicionale të mësimdhënies bëhet si gjatë takimeve në departament edhe në seminar/ëorkshope për përditësimin e syllabuseve dhe trajnimin e stafit për to.</p> <p>Stafi akademik është pjesëmarrës në trajnime si brenda dhe jashtë vendit. Gjatë trajnimeve në kuadër edhe të shkëmbimeve ndërkombëtare shkëmbehen eksperiencat. Kjo është e lidhur edhe me mobilitetit e stafit.</p> <p>Gjatë hartimit të raportit, prill 2021 ishte vendosur ky info në faqen web të KU BEDER për pjesëmarrje në projekte dhe mobilitet.) https://www.beder.edu.al/sh/news/student/thirrje-per-aplikime-/1639</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Departamenti diskutojnë në mbledhjet e tyre edhe për ecurinë e pjesëmarrjes në këto porjekte dhe informacionet e përfituara.</p> <p>Evidenca 3: Rregullorja mbi organizimin akademik; Evidenca 4: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; Evidenca 5: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër; Evidenca 6: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë; Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu; Evidenca 21: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë Evidenca 30: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Informacioni për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive përcaktohen në grupin e dokumenteve themelore të KU BEDER. Kështu Rregullorja Themelore e KU Bedër, Rregullorja e Fakultetit, Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” përcakton se si do të jetë në përgjithësi klasifikimi i peshës specifike të secilit komponent në vlerësimin për studentët. Në këto dokumente përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 5-10 % pjesëmarrja; ▪ 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit); ▪ 20-30 % testimet gjatë vitit; ▪ 40-50 % provimi përfundimtar <p>Përqindjet mund të ndryshojnë nga një lëndë në tjetrën, por luhaten brenda këtyre klasifikimeve.</p>

	<p>KU BEDER i ka të publikuar informacionet për studentët të përmbledhura në një udhëzues “Guida e studentit”. Ky informacion u jepet studenteve, por gjendet edhe në faqen online</p> <p>https://www.beder.edu.al/static/docs/guida_e_studentit_shqip_17_4710.pdf</p> <p>Edhe rregulloret janë të publikuara në faqen ëeb të KU BEDER</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Syllabusi i secilës lëndës përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe detyrimet që duhen përmbushë studenti gjatë semestrit, si edhe mënyrën e vlerësimit për këto detyrime. Ky informacion u jepet studentëve në fillim të semestrit akademik dhe ndodhet edhe në sistemin e komunikimit elektronik, si edhe në faqen web të KU BEDER tek programet respektive të studimit.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve janë të publikuara në Sistemin Interaktiv Bedër – BIS. Sikurse përshkruhet në syllabuset e secilës lëndë, format e vlerësimit të njohurive janë të ndryshme për tu dhënë mundësi studentëve edhe të tregojnë progresivisht ecurinë e thithjes së informacionit dhe të nxënit, ashtu edhe të pasqyrojnë qartë njohuritë e fituara në praktikë. Format e vlerësimit përfshijnë: testimet gjysëmfinale, projekte, detyra kursi, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në bashkëpunim me biznese ose agjenci që operojnë në treg, provime finale.</p> <p>Përmes këtyre formave të vlerësimit, studentët demonstrojnë jo vetëm shkallën e njohurive teorike që ata kanë fituar në auditor, por edhe tregojnë se si janë zhvilluara aftësitë e tyre komunikative dhe se si i aplikojnë njohuritë në punë konkrete praktike, si i zhvillojnë aftësitë e punës në grup, aftësitë e komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të zhvillojnë aftësitë prezantuese, analizuese dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.</p> <p>Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve; Evidenca 30: Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC; Evidenca 34: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve; Evidenca 44: Vendim për ngritjen e jurive të tezave bachelor; Evidenca 59: Praktikë ankimim note Evidenca 87: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përcaktojnë testimin e studentëve. Ato bazohen në rregulloren e programit të studimit, dhe gjithë kuadrin nënligjor institucional. Më poshtë është dhënë një nga syllabuset e lëndëve përsa i takon vlerësimit.</p>

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Sikurse shikohet, studentët testohen për vlerësimin e nivelit të njohurive të studentëve realizohet në provimet e ndërmjetme (java e 8-të e semestrit) dhe provimet përfundimtare (java 15 dhe 16 e semestrit). Ndërmjet tyre zhvillohen kuize, teste, projekte, detyra, etj studentët testohen me provime gjysmëfinale dhe finale, si edhe me projekte dhe testime/konkurse/quiz gjatë gjithë vitit.</p> <p>Kjo formë është e përgjithshme dhe vihet re edhe në lëndët e tjera.</p> <table border="1" data-bbox="603 398 1433 712"> <thead> <tr> <th colspan="3">MËNYRA E VLERËSIMIT TË LËNDËS</th> </tr> <tr> <th>Notat e ndërmjetme</th> <th>Sasia</th> <th>Përqindja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Notat gjysëm finale</td> <td>1</td> <td>20</td> </tr> <tr> <td>Kuize</td> <td>2</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Projekte</td> <td>1</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>Projekte semestrare</td> <td>1</td> <td>25</td> </tr> <tr> <td>Punë laborator</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Pjesëmarrja në mësim</td> <td>-</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>-</td> <td>60</td> </tr> <tr> <td>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</td> <td>-</td> <td>60</td> </tr> <tr> <td>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</td> <td>1</td> <td>40</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td></td> <td>100</td> </tr> </tbody> </table>	MËNYRA E VLERËSIMIT TË LËNDËS			Notat e ndërmjetme	Sasia	Përqindja	Notat gjysëm finale	1	20	Kuize	2	5	Projekte	1	10	Projekte semestrare	1	25	Punë laborator	-	-	Pjesëmarrja në mësim	-	-	Total	-	60	Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final	-	60	Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final	1	40	Total		100
MËNYRA E VLERËSIMIT TË LËNDËS																																					
Notat e ndërmjetme	Sasia	Përqindja																																			
Notat gjysëm finale	1	20																																			
Kuize	2	5																																			
Projekte	1	10																																			
Projekte semestrare	1	25																																			
Punë laborator	-	-																																			
Pjesëmarrja në mësim	-	-																																			
Total	-	60																																			
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final	-	60																																			
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final	1	40																																			
Total		100																																			
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Përmes sistemit Beder Information System BIS bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Gjithashtu platformën G-Suite përdoret edhe për aplikimin e testeve të ndryshme. Më të përdorshme testimet online janë zhvilluar në këto dy vitet e fundit akademike, të diktuar edhe nga rrethanat e pandemisë Covid-19.</p>																																				
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, në Nenin 19-24 përcakton mënyrën e realizimit. Lëndët e ndryshme që jepen në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” janë përgjithësisht me një titullar lënde dhe në disa raste ka edhe një asistent. Janë këta që bëjnë vlerësimin e njohurive, gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Departamenti ngre komisione për provimet dhe punimet e diplomave. Ndërsa për vlerësimet gjatë vitit mësimor, ato realizohen nga pedagogu i lëndës dhe asistenti (në se lënda e ka një të tillë). Sipas rregullores, prezantimet e punimeve të diplomave të studentëve duhet të realizohen përpara një komisioni prej tre anëtarësh të stafit akademik, të përzgjedhur nga departamenti. Edhe udhëheqësi i temës është në përbërje të komisionit vlerësues.</p>																																				
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Realizimi i testeve behën me shkrim dhe testet janë të sekretuara/anonime. Testet mund të jenë të koduara me bar kod ose jo.</p>																																				
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Çdo provim ka edhe çelësin e tezës së provimit. Në secilin rast që studentët kanë nevojë për konsultime, pedagogët janë të gatshme të diskutojnë më ta për ecurinë e mbarëvajtjes së mëtejshme të procesit mësimor. Duke qesë se lëndët në këtë program studimi janë në grupe jo masive, pedagogët kanë mundësinë e kontaktit dhe diskutimit m studentët në grupe të vogla për ecurinë e provimeve.</p>																																				

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Rregullorja "Për disiplinën e studentëve", ka të sanksionuar dënimin e kopjes dhe plagjiaturës.</p> <p>Po kështu, kjo është e shënuar edhe në çdo syllabus lënde ... <i>“Studenti është i detyruar të respektojë rregullat e etikës të përfshira në rregulloret e brendshme si Rregullorja e Disiplinës së Studentëve, Rregullat mbi Organizimin e Provimeve etj. Studenti mban përgjegjësi të plotë në çdo rast shkeljeje të rregullave lidhur me organizimin e provimeve, plagjiaturën, falsifikimin. Gjithashtu, mban përgjegjësi në rast të shkeljeve të të gjitha normave të tjera që rregullojnë marrëdhëniet mes studentëve me njëri-tjetrin dhe me personelin akademik dhe atë mbështetës.”</i></p> <p>Rastet e dyshuara për kopje ose plagjiaturë trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Punimet e diplomave në rast dyshimesh mund të kontrollohen edhe me anë të platformave të disponueshme falas dhe me pagesë, përfshirë edhe G-Suite.</p>			
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Kalendari me javët e përcaktuar për provime bazohet në rregulloret përkatëse dhe i jepte studentit edhe në syllabuset e çdo lënde. Kalendari akademik miratohet në fillim të çdo viti akademik dhe bëhet publik për studentet në fillim të tij.</p> <p>Notat e studentëve hidhen edhe në sistemin BIS edhe në librat themeltarë pranë sekretarisë mësimore. “Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë” ka të përcaktuar edhe afatet kohore të publikimit të notave.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Edhe për ankesat e studentëve zbatohet rregullorja e programit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”. Sipas kësaj rregulloreje, studenti brenda një jave nga dita e publikimit të rezultatit, ka të drejtë të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore.</p> <p>Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedure dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve; Evidenca 44: Vendim për ngritjen e jurive të tezave bachelor; Evidenca 56: Rregullorja për disiplinën e studentëve; Evidenca 59: Praktikë ankimim note.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: right;">X</p>				

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që</p>	<p>Bazuar në: (i) Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, (ii) në dy raportet vjetore të</p>

<p>të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2018-2019 dhe 2019-2020 si edhe (iii) në syllabuset e lëndëve, studentëve u ofrohen informacione teorike dhe praktike, mundësi për tu zhvilluar në aftësitë e tyre profesionale, në përputhje me nivelin e njohurive të ciklit të parë të studimit.</p> <p>Mjaft nga lëndët e këtij programi, sidomos ato të vitit të dytë dhe të tretë zhvillohen me ndërthurje të elementëve praktikë, si edhe duke marrë eksperiencën reale nga tregu i medias dhe marketimit. Kjo realizohet si përmes përvojës së pedagogëve ashtu edhe nga leksionet e hapura, praktikat profesionale, konferencat, projektet dhe përfshirja në redaksinë e objektiv.al</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” ka në program mësimin e gjuhës së huaj, anglisht. Kjo është mjaft e rëndësishme, pasi edhe mjaft nga softëare që përdoren nga studentët në orët praktike, janë tërësisht në anglisht. Kjo bën që stafi akademik dhe studentet duke përdorur këto softëare të jenë gjithnjë të përditësuar me zhvillimet teknologjike. Për vete natyrën e programeve mediatike, atyre u duhet të ndjekin tendencat e reja në media dhe kjo është e lidhur edhe me një pjesë të stafit aktual që është në pozicione drejtuese në media apo organizata PR, duke sjellë risitë e reja në auditor.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Vlerësimi i kompetencave dhe aftësive të studentët në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” realizohen përgjatë gjithë vitit dhe në forma të ndryshme. Kjo i jep mundësi pedagogut të masë njohuritë dhe aftësitë e fituara. Pedagogët zhvillojnë edhe orë të hapura dhe diskutime me studentët për të nxjerrë në pah cilat nga aftësitë janë përthithur më mirë.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Nëpërmjet internshipeve dhe praktikave profesionale, studentët marrin info se cilat nga aftësitë e tyre janë më të përshtatshme në tregun e punës dhe çfarë duhet të thellojnë më tej. Kjo realizohet duke komunikuar edhe me pedagogët dhe në secilën lëndë.</p> <p>Gjatë vitit 2020-2021 si pasojë e pandemisë dhe detyrimit të zhvillimit të mësimin online, në komunikim me studentët është theksuar përdorimi i teknologjive të reja në marketim dhe komunikimin publik.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Siç vërehet edhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, stafi akademik i departamentit angazhohet në aktivitete jashtëkurikulare. Stafi është pjesëmarrës në kuadër të konferencave shkencore si edhe organizon ëorkshope. Departamenti harton çdo fillim viti një plan aktiviteteve ku janë të evidentuara edhe leksione/ ëorkshope të hapura. Lektorë në to mund të jenë në varësi të tematikës, si stafi akademik ashtu edhe nga jashtë institucionit, kryesisht industria/media dhe PR offices.</p> <p>Me një emërtim “MarCom” (Marketing & Komunikim) dhe “Studenti dhe profesioni” gjendet të renditura në Raportet vjetore disa seminare/ëorkshope të tillë. Të ftuarit janë edhe profesionistë të medias të cilët flasin për sfidat e gazetarisë dhe komunikimit në përgjithësi, por edhe përfaqësues të industrive të ndryshme me kërkesat që ata kanë ndaj stafit të ri për profesionet e lidhura me këtë profil studimi. Situata e pandemisë Covid 19 i ka penguar gjatë semestrit të dytë 2019-2020 dhe fillimit të vitit mësimor 2020-2021 realizimin e leksioneve të tilla të hapura dhe ëorkshope.</p>




<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Stafi akademik ka kompetencë në lëndët kua ata janë titullarë dhe mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, te cilat janë të përcaktuara saktësisht në programet e lëndëve. Studentët e shkencave të komunikimit kanë patur në godita e mëparshme një bazë shumë të mirë laboratorike/mediatike për të realizuar programin e studimit e programit. Edhe në godinat e reja të zhvendosura, kjo bazë po rivendosej në shërbim të studentëve. Gjatë kohës së hartimit të këtij raporti, në rrjetet sociale të shkollës u pa përfundim i sallës së teknologjisë mediatike.</p> <p>Gjithashtu studentet e programit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” përdorin edhe portalin www.objektiv.al për të testuar praktikisht njohuritë e tyre.</p> <p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të fushës së marketingut, marrëdhënieve publike, medias dhe komunikimit, me qëllim realizimin e programit. Këto i shërbejnë fitimit të kompetencave dhe aftësive të studentet.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Siç shihet edhe nga syllabuset e lëndëve, një pjesë e rëndësishme e vlerësimit të njohurive është edhe përmes punëve të përbashkëta në grup dhe diskutimeve rreth tyre.</p> <p>Edhe në mbledhje të Këshillit të Departamentit janë diskutuara tematika të sjella nga studentët (procesverbali i mbledhjes së Departamentit 17/04/2019) Diskutimi mbi “gazetarinë investigative dhe drejtësinë” – prezantim i studentëve. Stafi kryen çdo semestër të tilla diskutime me studentët. Gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë edhe këto aktivitete janë kufizuar.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Kërkimi shkencor i studentëve ndërthuret kryesisht me atë të pedagogëve për tematika studimi që lidhen edhe me programet e studimit dhe projektet që KU BEDER mund të ketë. Pranë KU Bedër funksionon Zyra e Kërkimit Shkencor që koordinon aktivitetet me njësitë e tjera organizative. Kolegji jep edhe mbështetje financiare për pedagogët e tij për pjesëmarrjen e tyre në veprimtari kërkimore, konferenca ndërkombëtare dhe publikime. Pedagogët aplikojnë për këtë mbështetje financiare në bazë të kriterëve të përcaktuara në “Praktika e mbështetjes financiare për pjesëmarrje në konferenca” dhe “Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor”.</p> <p>Rregullorja mbi Kërkimin Shkencor përcakton mënyrën e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe përgjegjësitë e organeve kompetente dhe kërkuesve shkencorë.</p> <p>Studentët gjithashtu inkurajohen të zhvillojnë ide inovative në detyra e projekte, të avancojnë dhe promovojnë punimet e tyre në bashkëpunim me pedagogët. Gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë edhe këto aktivitete janë kufizuar.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” dy pedagogë, konkretisht përgjegjësi i departament Erlis Çela dhe pedagogjia Anxhela Hoxha kanë angazhuar studentët e tyre në aktivitetet shkencore si në punime individuale ashtu edhe në bashkëpunim me të tjerë. Pothuajse të gjithë studentët e këtij programi janë përfshirë.</p>

	<p>Studentët gjithashtu bashkëpunojnë në klubet studentore dhe nëpërmjet Dekanit të studentëve në aktivitetet sociale të ndryshme. Duke qenë se i përkasin medias, ata kanë punuar për mediatizimin e aktiviteteve / konferencave / leksioneve të hapura që fakulteti apo KU Beder ka zhvilluar, duke i bërë ato pjesë e platformave sociale, faqeve web etj. Siç u shprehën pedagogët në diskutimet online me GVJ një nga idetë e studentëve ishte përfshirja e anketimeve dhe promovimeve nëpërmjet platformës Tik Tok.</p> <p>Konferencave studentore janë një mjet tjetër në funksion të promovimit dhe nxitjes së studentëve. Në fund të çdo viti akademik, promovohen punimet e studentëve duke shpallur tre tezat më të mira për studentët e nivelit Bachelor.</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>KU Beder ka marrëveshje bashkëpunime me institucione të vendit dhe të huaja. Të tilla janë marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me Universitetin Aurel Vlaicu Unversita of Arad, Rumani; marrëveshje mobiliteti për staf dhe studentë me College of Applied Sciences, "Lavoslav Rurilta" in Vukovar, Kroaci. Të dy këto marrëveshje janë në kuadër të programit Erasmus+.</p> <p>Në pragramë të tjera bashkëpunimi mbështetur edhe nga Ambasada e SHBA në Tiranë/Departamenti Amerikan i Shtetit, 3 studentë të nga departamenti i Shkencave të Komunikimit kanë marrë pjesë në program mobiliteti në periudhën 4 korrik – 11 gusht 2019 në programin SUSI (Study of the U.S. Institutes), për studentët ndërkombëtarë, nga mosha 18-25 vjeç. SUSI përfshin 4 javë mësimë akademike, trajnime, diskutime, leksione dhe punë vullnetare. Ndërsa java e fundit konsiston në vizitat e vendeve të ndryshme në USA. Studentët pjesëmarrës kanë mundësi të takohen dhe të shkëmbejnë eksperiencat me bashkëmohatarët e tyre amerikanë, gjatë qëndrimit në kampus. Në sezonin e verës 2019, midis 4 studentëve të zgjedhur nga Shqipëria, tre prej tyre ishin studente në Departamentin e Shkencave të Komunikimit pranë KU Bedër.</p> <p>Në sezonin e verës 2020 dy studente të tjera të Departamenti të Shkencave të Komunikimit u përzgjedhën për të marrë pjesë në këtë program për sezonin Verë 2020, i cili më tej u anulua si pasojë e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19.</p> <p>Një program tjetër ku kanë aplikuar studentë të departamentit të Shkencave të Komunikimit është Programi Global i Shkëmbimit Undergraduate (Global UGRAD), i cili ofron bursë për një semestër të studimeve akademike në një kolegji ose universitet amerikan, por që nuk përfundon me diplomim, për të rinj nga grupe të ndryshme, studentë me potencial në lidhshmëri. Global UGRAD është një program i Byrosë së Çështjeve Arsimore dhe Kulturore të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara dhe synon të rekrutojë pjesëmarrës nga prejardhje të nënpërfaqësuar, të cilët nuk kanë pasur mundësi të tjera për të studiuar në Shtetet e Bashkuara.</p> <p>Studentë të programi "Bachelor" në "Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu" kanë marrë pjesë edhe në programe të angazhimit vullnetar me organizata studentore siç është AIESEC, e cila është një platformë globale për të rinjtë për të eksploruar dhe zhvilluar potencialin e tyre të lidhshmërit. AIESEC një organizatë jo-politike, e pavarur, jofitimprurëse e drejtuar nga</p>

	<p>studentë dhe të sapodiplomuar të institucioneve të arsimit të lartët cilët janë të interesuar në çështjet botërore, lidhësi dhe menaxhim.</p> <p>Ndërkohë që hartohet ky Raport , në faqen online të KU Beder gjendet edhe një njoftim tjetër i vendersur me 1 prill për mobilitet të stafit në kuadër të programeve Erasmus.</p> <p>https://www.beder.edu.al/sh/news/announcements/programe-e-shkembimit-erasmus-/1638</p> <p>Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu;</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca 32: Evidenca nr. 32 Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kerkimit Shkencor;</p> <p>Evidenca 34: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve;</p> <p>Evidenca 35” Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019;</p> <p>Evidenca 36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	<p>Ky është viti i parë i diplomimit të studentëve në programin Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”. KU BEDER lidhur me procesin e diplomimit ka një grup të tërë dokumentesh që e trajtojnë dhe vendosin piketat e tij Ato janë: (i) Rregullorja Themelore të institucionit; (ii) Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë; (iii) Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”; (iv) Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë; (v) syllabusi i lëndës “Punim diplome”.</p> <p>“Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë” në listën e dokumentacionit të përcjellë ishte në gjuhën angleze dhe duhet kthyer në shqip.</p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	<p>Programi i studimit ka një lëndë të veçantë dhe një pedagogje të dedikuar për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës. Syllabusi i “Punimi i diplomës jepet tek studentët që me fillimin e vitit akademik dhe gjithashtu është edhe i publikuar.</p> <p>Me fillimin e semestrit të gjashtë mësimore për programin (pra semestri i dytë i vitit të tretë, studentët fillojnë dhe përcaktojnë tematikat e përafërta të diplomës si edhe udhëheqësit e temës së diplomës. Këta udhëheqës i asistojnë studentët për materialet që mund t'i ndihmojnë ata të kryejnë punën e tyre kërkimore-shkencore.</p>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studentët në programin Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” realizojnë një punim diplome dhe jo provim final.</p> <p>Përzgjedhja e temës është një proces që diskutohet në gjerësi në Departament dhe me studentët, si për të zgjedhur tematikën ashtu edhe për pedagogun udhëheqës.</p> <p>Si pjesë e kurrikulës gjatë kohës së përgatitjes së punimit të diplomës janë 9 seanca metodologjike dhe këshillimi, seanca për anketat dhe intervistat, për hartimin e hipotezave, për analizimin e gjetjeve, etj. Këto e ndihmojnë studentin hap pas hapi në realizimin e temës.</p> <p>Si pedagogu i lëndës, ashtu edhe udhëheqësi i temës orientojnë studentin edhe për literaturën që duhet të përdore, për përmbajtjen ashtu edhe për formën e punimit të diplomës.</p> <p>Sikurse është vepruar edhe në punimet e diplomës në studentët e programeve të tjera të studimit, për çdo grup caktohen 3 pedagogë të cilët luajnë rolin e udhëheqësit të diplomës për studentët e programit. Pas caktimit të mbikëqyrësit, studenti dhe anëtari i stafit akademik janë rregullisht në kontakt gjatë gjithë semestrit deri në përfundim të procesit.</p> <p>Studenti dhe udhëheqësi i temës bashkëpunojnë në realizimin e temës dhe mbledhjen e materialeve. Materialet sasiore mund të mblidhen edhe nga sondazhe të bërë në kuadër të projekteve ku kanë marrë pjesë studentët, por edhe si studim i mirëfilltë më vete, duke shfrytëzuar praktikatat profesionale, sondazhet online, apo forma të tjera. Infrastruktura e fakultetit, laboratorët dhe biblioteka, janë të hapur dhe gjatë sezonit të provimeve ato punojnë edhe në fundjavë.</p> <p>Roli i udhëheqësit të temës shtrihet në të gjitha planet, që prej fillimit të procesit. Ai asiston studentin në (i) përcaktimin e hipotezës së punimit; (ii) hartimin e pyetësorëve sasiore në mbledhjen e të dhënave; (iii) përpunimin dhe përzgjedhjen e literaturës për temën; (iv) hartimin e skicës së temës bazuar në manualin e punimit të diplomës për studentët e ciklit të parë; (v) nxjerrjen e rezultateve.</p> <p>Udhëheqësi është ai që përcakton se kur tema është gati ti paraqitet komisionit të diplomës.</p> <p>Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite, programi i lëndës “Punim diplome” faqe 204-206 Evidenca 87: Manual për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentin vlerësohet me notë.</p>	<p>Pas dorëzimit dhe prezantimit final të punimit të diplomës, studentin vlerësohet me notë. Kjo notë është e dukshme edhe në dokumentin final/ listën e notave kur studentin tërheq diplomën.</p> <p>Komisioni vlerësues ka tre anëtarë, dhe njëri është udhëheqësi i diplomës.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentin pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Suplementi i notave të studentëve është në formatin e miratuar nga Ministria e Arsimit. Ai ka të përshkruara të gjitha lëndët, vlerësimet dhe kreditet e marra gjatë të tre viteve akademike. Studentin quhet se plotëson të gjitha kërkesa dhe merr diplomën kur ka marrë 180 kredite sipas sistemit ECTS dhe nuk ka asnjë notë të vlerësuar me (D- ose F).</p>

	Ky është viti i parë akademik me diplomimin e një grupi studentësh në programin Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”. Gjatë kohës që u zhvillua vizita online kishte përfunduar semestri V dhe ishte në fillim të procesit të përcaktimit të diplomave bazuar në Manualin e përgatitjes së tezës së diplomës dhe syllabusin e lëndës përkatëse.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programi i zhvilluar mund të aksesohet nga studentët në çdo moment, nëpërmjet sistemit interaktiv BIS, sa kohe ata janë në shkollë. Në përfundim të studimeve, studenti merr diplomën dhe listën e notave. Me kërkesë prej tij, studenti pajiset me një kopje zyrtare, të vulosur, të programit të plotë të studimit të zhvilluar, syllabuseve, etj			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Dokumentacioni i studentit pas diplomimit, ruhet në zyrat e arkivës. Në rast të kërkesave specifike të studentëve, ata mund të marrin vërtetimi që dëshmojnë ecurinë e tij në këtë program studimi, sipas nenit 11 të Rregullores së Arkivës. Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu; Evidenca 19: Syllabuset e lëndëve; Evidenca 35” Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019; Evidenca 36: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020. Evidenca 38: Rregullorja e Arkives; Evidenca 87: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo	Institucioni ka hartuar dosjet përkatëse të çdo anëtari të programit, me kohë të plotë dhe të pjesshme. Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe evidencën shoqëruese të dorëzuar nga institucioni [Evidenca nr.88] informacioni i përfshirë në dosje dhe dokumentat shoqërues, mundësojnë mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave për stafin e institucionit. Grupi i vlerësimit të jashtëm pati mundësinë për të kërkuar në mënyrë të rastësishme, dy dosje të dy anëtarëve të stafit, një me kohë të plotë dhe një me kohë të pjesshme. Të

<p>semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>dyja dosjet ishin të rregullta dhe përmbanin të gjithë informacionin e nevojshëm të anëtarëve të stafit, përfshirë: diplomat e tyre përkatëse, kontratat e punës si dhe certifikata të formimit profesional.</p> <p>Në dosje gjendej gjithashtu edhe dokumentacioni i nevojshëm për proceset e punësimit të rregullt si përshembull CV, raporti mjeko-ligjor. Lista e dokumenteve që përfshiheshin në dosje u dërgua edhe ekipit të vlerësimit të jashtëm, si dhe është dorëzuar si evidencë nr 88, në dosjen e dokumentave të institucionit.</p> <p>Dosjet kishin emërtime të dukshme me emrin e anëtarit përkatës të stafit si dhe një fotografi, në kopertinën e çdo dosjeje.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 88 Lista e të dhënave të dosjes së stafit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Procedurat e rekrutimit, siç janë shpjeguar në raportin e vlerësimit të brendshëm dhe evidencat shoqëruese të dorëzuara nga institucioni [Evidencat nr.5 dhe nr.13], Procedura e Punësimit të Personelit; Rregullorja themelore dhe Statuti i Kolegjit universitar Bedër, janë të hartuara në përputhje me legjislacionet në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. Këto procedura u shpjeguan qartë edhe nga punonjësja e burimeve njerëzore të institucionit, gjatë vizitës virtuale të grupit të vlerësimit të jashtëm.</p> <p>Rregullorja themelore e Kolegjit universitar Bedër, në Nenin 26 shpjegon mjaft qartë të gjitha hapat që ndiqen për rekrutimin e stafit të ri, që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgjegjësi i departamenti përkatës propozon kriteret për vendet e lira të punës që duhet të plotësojnë kandidatët; - Dekani i Fakultetit vlerëson kërkesat e paraqitura për rekrutim të stafit të ri akademik me kohë të plotë dhe kërkesa e miratuar i dërgohet Rektorit për vlerësim; - Pas aprovimit nga ana e Rektorit, i përcillet për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës, Zyrës së Burimeve Njerëzore; - Kjo e fundit publikon vendet vakante në ëeb-in e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe/ose pranë Zyrës së Punës; - Përzgjedhja e kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit, bëhet nga një komision i përbërë nga Dekani i fakultetit përkatës, Përgjegjësi i Departamentit përkatës si dhe një nga personeli akademik i njësisë bazë; - Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore ndjek procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve pa të drejtë vote dhe në rast konstatimi të parregullsive në procedurë, përpilon relacionin përkatës drejtuar Rektorit; - Komisioni analizon përshtatshmërinë e aplikimit me vendin e lirë të punës dhe vendimin e miratuar me shumicë të thjeshtë ia paraqet për miratim Rektorit i cili miraton një prej tyre.

	<p>Në takimet me Shefin e Departamentit dhe specialisten e Burimeve njerëzore, hapat u shpjeguan, siç përmbahen në rregullore.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 5 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër.pdf Ref: Evidenca nr. 13 Procedura e punësimit të personelit.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret për rekrutimin e stafi të ri hartoheshin nga departamenti, në bazë të nevojave të identifikuara. Këto kritere, për stafin me kohë të plotë, sic evidentohet edhe në Raportin e Vlerësimit të Bredshëm dhe evidencën shoqëruese të dorëzuar nga institucioni kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zotërimin e një grade shkencore, - përvojë në mësimdhënie në fushat e medias, komunikimit, marketingut, - profesionalizëm në mësimdhënie, menaxhim projektesh si dhe këshillim studentësh, - njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, - eksperiencë në kërkimin shkencor dhe pjesëmarrje në projekte, - njohuri të gjuhës angleze. <p>Informacionet publikohen edhe në rrjetet sociale, edhe brenda afateve në faqen web. Pas një afati kohe info hiqet nga faqja web.</p> <p>Ref: Evidenca nr.47 Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për rekrutimin e stafit të ri dhe për vlerësimin e kandidatave mbështet në kritere të përgjithshme për stafin akademik dhe specifike për fushën e mësimdhënies.</p> <p>Vihet re që institucioni i jep një rëndësi të konsiderueshme kandidatave të cilat vijnë nga profesionet e aplikuara dhe nga përvoja profesionale jo domosdoshmërisht të lidhura vetëm me akademinë (sidomos për lëndët karakterizuese dhe për stafin me kohë të pjesshme).</p> <p>Ref: Evidenca nr.47 Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi IV.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe evidencat e paraqitura në dosjen e institucionit [Shtojca 1], duket qartë që institucioni ka një mjedis të përshtatshëm për kryerjen e detyrave të prsonelit në mënyrë efikase. Gjithashtu, nga vizita në institucion (online) u pa se mjediset e kolegjit universitar Bedër ishin të përshtatshme, për stafin akademik, me zyra me hapësirë dhe kushte të nevojshme për një performancë të mirë në mësimdhënie. Edhe ambientet e zhvillimit të mësimit ishin të</p>

	<p>përshtashme me kushtet e nevojshme fizike për stafin akademik për të krijuar një mjedis cilësor për mësimdhënie.</p> <p>Ref: Shtojca 1. Mjediset e Fakultetit/njësive bazë (tabela 16)</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Njësies për Sigurimin e Cilësisë, angazhohet për zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit. Në evidencën nr.22, e paraqitur nga institucioni për këtë qëllim reflektohen një sërë temash trajnimesh të cilat janë organizuar për stafin gjatë vitit të kaluar dhe janë në agjendën e trajnimit për këtë vit (2021). Vërehet se temat janë me vlerë si p.sh. Kuadri Ligjor për Arsimin e lartë dhe procedurat administrative, por ka edhe tema të cilat mund të jenë bazike për nivelin e stafit pedagogjik si p.sh.: Zhvillimi i Aftësive Menaxhuese apo Mjetet Ndihmëse të Kërkimit.</p> <p>Institucioni organizon trajnime me fokus të veçantë në metodat interaktive të mësimdhënies. Dy nga trajnimet e zhvilluara së afërmi lidheshin me: Organizimin e seminareve dhe Përdorimin e platformës online, të cilat janë me mjaft vlerë, sidomos për stafin e ri dhe atë me kohë të pjesshme që jo domosdoshmërisht vjen nga një karrierë akademike e mëparshme.</p> <p>Institucioni ka zhvilluar edhe trajnime si “Mësimdhënia dhe përmirësimi i përmbajtjes së syllabuseve” nga Profesorët dhe drejtuesit e IAL.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 22 Plani i trajnimeve të personelit.</p> <p>Ref: Edidevca shtese Lista e trajnimeve</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni ka të angazhuar një numër të mjaftueshëm pedagogësh me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme për përmbushjen e nevojave të programit të studimit. (shih Standardin II.5)</p> <p>Të gjithë lektorët me kohë të plotë kanë titull Dr, një prej lektorëve ka titullin Prof.As dhe të gjithë asistentë lektorët kanë kualifikimin Msc.</p> <p>Edhe lektorët me kohë të pjesshme kanë së paku kualifikimin Msc dhe vijnë nga një sërë fushash dhe disiplinash të lidhura me programin e studimit. Në zyrën e Burimeve Njerëzore ishte vetëm një punonjëse e cila mbulonte marrëdhëniet e punës dhe koordinimin për të gjithë stafin e institucionit të përbërë prej më shumë se 100 persona staf me kohë të plotë dhe të pjesshme.</p> <p>Ref: Evidenca nr.25 Vendimi i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore.pdf; Ref: Shtojca 1 Tabela 4</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni është zhvendosur së fundmi në një godinë të re. Sipas përshkrimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, institucioni ka edhe një seri mjedisesh të dedikuara këtij programi studimi dhe që janë në ndihmë të një procesi praktik të të mësuarit për studentët. Të tilla janë: neësroom, muzeu i medias dhe komunikimit, laboratorit i gjuhëve të huaja dhe kompjuterave, etj.</p> <p>Në evidencën e paraqitur në dokumenta e akreditimit, si shtojcë e raportit të vlerësimit të brendshëm, në tabelën 16, raportohet për një sipërfaqe totale prej 2732.5m² si mjedise për Fakultetin përgjegjës për programin e studimit. Në total në fakultet janë 603 studentë, dhe institucioni llogarit një normë prej 4.53 m²/ student.</p> <p>Nga vizita (virtuale) e ekspertëve në mjediset e reja të institucionit u vu re se klasat mjediset mësimore ishin të mjaftueshme, të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për zhvillimin e një orë interaktive mësimore. Ambientet ishin me hapësira të mjaftueshme, dhe komode për studentët. Të gjitha ambientet mësimore përshatashin me numrin e studentëve që frekuentojnë programin.</p> <p>Ref: Shtojca 1 (tabela 16) Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore ishin të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për zhvillimin e një orë mësimi interaktive.</p> <p>Në klasa kishte kompjutera, tabelë projektimi, tabela interaktive dhe internet. Këto mjedise, janë të gjitha të pajisura me kondicionim dhe ndricim të mjaftueshëm.</p> <p>Ref: Shtojca 1 (tabela 16) Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Përveç mjediseve mësimore, për programin që po vlerësohet, institucioni ka zhvilluar edhe një Neësroom, si dhe një muze të medias dhe komunikimit, në të cilin studentët njihen më nga afër me pajisjet teknologjike të përdorura për komunikimin masiv, si dhe atyre më të reja.</p> <p>Të tilla mjedise u mundësojnë studentëve aftësimin praktik, përpos njohurive teorike që marrin nga programi në kuadër të përbushjes së objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Studentët që ndjekin programin Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu, kanë në dispozicion dy laboratorë të kompjuterave në të cilin kanë qasje sipas nevojës. Kompjuterat e këtij laboratorit ishin të pajisur më të gjithë programet e nevojshme që iu duhen studentëve të programit për të kryer detyrat e tyre praktike.</p> <p>Ref: Shtojca 1 (tabela 16) Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë</p>	<p>Shumica e studentëve të këtij programi, kishin mundësi të kryenin praktikë profesionale pranë Neësroom të ngritur nga departamenti, nëpërmjet portalit Objektiv.al. Gjithsesi nga një kontroll online për</p>

të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	Objektiv.al, i vetmi rezultat janë një seri fotografish nga aktivitetet të studentëve të këtij programi (datuar më janar 2019). Shumica e studentëve i kryejnë praktikat profesionale në biznese me të cilat institucioni ka lidhur marrëveshje për këtë qëllim. Një listë e detajuar e këtyre marrëveshjeve është paraqitur edhe në evidencën nr. 55, të dorëzuar nga institucioni. Ref: Website i institucionit www.objektiv.al Ref: Evidenca nr. 55 Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga raporti i vlerësimit të brendshëm dhe evidenca e paraqitur nga institucioni [nr. 63], shihet që institucioni garanton akses për studentët në bibliotekën mësimore dhe garanton shfrytëzimi në barabartë të mundësive të saj, për studentët e programit. Gjithashtu nga vizita (virtuale) e grupit të vlerësimit në bibliotekën mësimore u pa se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për këtë qëllim. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe një fond librash fizik të konsiderueshëm. Gjithashtu biblioteka ka rregulla të qarta, orare të mirëpërcaktuara dhe ishte e pajisur me kompjutera, ku studentët mund të bëjnë edhe kërkime online apo në fondin elektronik të institucionit. Ref: Evidenca nr 63 Udhëzim mbi funksionimin e Bibliotekës
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka përmban një fond prej 26. 000 titujsh prej të cilëve rreth 560 tituj i përkisnin librave të lidhur me programin që po vlerësohet: Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu. Falë ndihmës prej aktorëve ndërkombëtarë (Ambasada Amerikane në Tiranë) biblioteka e kishte pasuruar fondin e saj edhe më tepër. Gjithsesi, shumica e librave që i përkasin këtij programi studimi ishin në gjuhë të huaj, përgjithësisht anglisht, kjo për shkak të mungesave të librave të përkthyer në shqip për temat e komunikimit dhe marketingut. E njëjta situatë edhe për revista shkencore. Një pjesë e mirë e nevojave të studentëve për materiale referuese, tekste plotësohen edhe nga platforma JStor. Kjo platformë është mjaft e rëndësishme sepse u mundëson studentëve literaturë shumë bashkëkohore, Kjo platformë u mundëson studentëve që edhe nëpërmjet email të marrin

	<p>info/ artikuj/ teza doktoraturash/ studime/ kapituj të veçantë edhe pa qenë nevoja e pranisë fizike në bibliotekë.</p> <p>Ref: Shtojca 1 Tabela 17 Te dhena te plota per latformat online/Struktura e teknologjise se informacionit/Biblioteka/Biblioteka online etj.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni krijonte qasje në librarinë JStore për studentët. Ky akses është i hapur, pa pagesë për studentët.</p> <p>Ky akses ishte i siguar edhe për stafin pedagogjik. Sipas evidencës së paraqitur nga institucioni nr. 43, marrëveshja me Jstor është nënshkruar edhe për vitin akademik aktual.</p> <p>Ref: Evidencë nr 43, Marrëveshja për akses në JSTOR</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ishte e pajisur me kompjutera dhe internet për studentët, që do duan të shfrytëzojnë programet apo mjediset e bibliotekës për të kryer kërkime online apo realizim të detyrave të ndryshme.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas Raportit të vlerësimit të brendshëm të institucionit si dhe evidencave përkatëse të paraqitura, institucioni zhvillon herë pas here përditësim të fondit të bibliotekës me synim pasurimin e saj dhe shtimin e zërave. Sipas evidencës së paraqitur nga insitucioni [nr 91], në projekt- buxhetin e departamentit të shkencave të komunikimit për vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020, ka pasur një ze në buxhet për blerjen e literaturës për degën Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.</p> <p>Sipas bisedës me punonjësen e bibliotekës kërkesat për pasurimin e fondit të bibliotekës vinin nga studentët e programit si dhe stafi akademik. Gjatë viteve të fundit bilbioteka kishte parë një rritje të fondit edhe në sajë të përpjekjeve të shefit te departamentit dhe anëtarëve të tjerë të stafit me aktorë të jashtëm, për të pasuruar fondin me tituj dhe literaturë që është në funksion të rritjes së mundësive të studentëve për njohuri dhe tekste të përditësuara në fushën e tyre të studimit.</p> <p>Sugjerohet që fokusi i institucionit për vitet e ardhshme për pasurimin e bibliotekës të përqendrohet në ato tituj,që janë tekstet e deklaruara në syllabus ose që janë ngushtësisht të lidhura me këto tekstet bazë, por që mungojnë në bibliotekë.</p> <p>Ref: Evidenca 91 Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Mjediset e bibliotekës ishin në dispozicion të studentëve, përgjatë orarit të tyre mësimor si dhe me orare më të zgjatura në raste të tjera (kohë provimesh). Të gjithë studentët e marrin informacionin e plotë mbi oraret e frekuentinimit të bibliotekës dhe kapacitetet e saj. Evidenca e paraqitur nga institucioni nr. 63, paraqet të gjitha këto rregulla, në mënyrë të qartë, në nenin 6 të saj.</p> <p>Ref: Evidenca nr 63 Udhëzim mbi funksionimin e Bibliotekës</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një sistem menaxhimi të brendshëm të informacionit nëpërmjet platformës Bedër Information System (BIS). Siç tregohet në raportin e vlerësimit të brendshëm të institucionit ky sistem bën të mundur ruajtjen e të gjithë të dhënave të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të tyre të studimit në institucion. Gjithashtu, studentët dhe stafi akademik që mori pjesë në takimin me grupin e vlerësimit të jashtëm, ishin të njohur mirë me sistemin dhe mund të artikulonin qartë mënyrën e operimit të tij. Sistemi i operimit BIS është i mirëshpjeguar edhe në Udhëzuesin për përdorimin e këtij sistemi, i paraqitur si evidence nr. 33, në dokumentacionin e vlerësimit të programit. Ref: Evidenca nr 33 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sipas shpjegimeve të dhëna në RVB dhe evidencat e dorëzuara në dosjen e vlerësimit, sistemi i menaxhimit të Brendshëm BIS, ka llogari të hapura për secilën nga grupet, në institucion: studentët, pedagogët, këshilltarët akademike, dhe departamentet e tjera mbështetëse në institucion si p.sh. burimet njerëzore, biblioteka etj. Në sistemin e menaxhimit të Brendshëm institucioni ruan të gjitha të dhënat që lidhen me progresin e studentëve në ciklin e programit. Ref: Evidenca nr 33 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Qasja në sistemin e menaxhimit të brendshëm BIS, është e hapur për të gjithë stafin pedagogjik të programit, studentët dhe stafin mbështetës. Sipas informacioneve të dhëna në RVB dhe nga intervistat në institucion, grupit të vlerësimit të jashtëm iu shpjegua se ky sistem përfshinte të gjitha notat, lëndët, vlerësimet, dhe komunikimet e nevojshme të stafit pedagogjik me studentët si dhe komunikimet e këtyre të fundit me departamentet mbështetëse në institucion. Asnjë student apo staf nuk përmendi probleme me aksesin e sistemit të brendshëm të menaxhimit. Ref: Evidenca nr 33 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sic përshkruhet në shtojcën 1, tabela nr 17, institucioni ka të integruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit edhe platformën bedër.edu.al, e cila u ofron të gjithë përdoruesve llogari emaili me përdorim pa afat me adresë emermiemer@bedër.edu.al . Gjithashtu platforma one@bedër.edu.al është rihuar posacërisht për mesazhin dhe raportim online. Platforma mundëson jo vetëm shkëmbimin e informacionit me studentët përsa i përket përmbajtjes së lëndëve dhe orëve të mësimi por edhe ruajtjen e detyrave të studentëve, dorëzimin dhe vlerësimin. Ndërkohë nëpërmjet platformës BIS, menaxhohet gjithë sistemi i të dhënave të studentëve, që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve të tyre. Për personelin gjithashtu bëhet e mundur menaxhimi i dokumentacionit që prej fillimit të marrëdhënies së punës e deri në përfundimin e kontratës, së tyre.

	Ref: Shtojcë 1, Tabela nr 17 Të dhëna të plota për platformat online			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në sajë të platformës One.Bedër.edu.al , institucioni mundëson marrjen e të dhënave në kohë reale për të gjithë studentët, progresin e tyre, si dhe procedurat e nevojshme financiare dhe administrative. Kjo platformë, sic shpjegohet në RVB, është hedhur në funksionim për semestrin e pranverës të vitit akademik 2019-2020. Ref: Shtojcë 1, Tabela nr 17 Të dhëna të plota për platformat online			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni ka informacion të bollshëm në faqen elektronike Bedër.edu.al, e cila është lehtësisht e aksesueshme. Informacioni në faqe ofrohet në dy gjuhë dhe përmban gjithë informacionet për programet e studimit, aktivitetet e institucionit, stafit akademik, departamenteve të tjera mbështetëse etj. Nga një kontroll i thjeshtë i faqes (aksesuar më datë 8 mars 2021), vihet re edhe një kujdes i shtuar për të dhënë informacion të përditësuar për studentët dhe stafin akademik për situatën e lidhur me pandeminë e Covid-19, e cila përmban masat që duhen marre për higjenën, kalendarin akademik të ndryshuar, etj. Sugjerohet që disa kategori në ëbsite si psh: Galeria, Aktivitetet, Media, Kërkimi Shkencor, etj të përditësohen herë pas here, pasi informacioni i fundit i gjendur në faqe i përket vitit 2019, dhe nuk është i përditësuar. Ref: Faqja online e institucionit www.Beder.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni ka hartuar një raport financiar për të ardhurat e institucionit. Ky raport është përfshirë si tabela 18, si shtojcë në fund të raportit të vlerësimit të brendshëm. Të dhënat e paraqitura në këtë tabelë i përkasin institucionit dhe jo veçanërisht këtij programi studimi që po vlerësohet. Për këtë program, nuk ka një raport të dorëzuar për të ardhurat apo shpenzimet. Ref: Shtojca 1, tabela nr 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në	Institucioni ka dorëzuar në dosjen e vlerësimit, edhe një plan financiar ku reflektohen të ardhurat për institucionin, për tre vitet e fundit, të cilat vihen edhe në shërbim të programit. Është e nevojshme që ky plan financimi të reflektojë edhe shpenzime specifike për programin, të ndara në zëra të vecantë, në mënyrë që të bëhet e mundur edhe adresimi i nevojave të programit, hap pas hapi. Zërat, mund të përfshijnë financimet për burimet njerëzore, shpenzimet operationale

bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	për programin, shpenzimet për bibliotekën, dhe zëra të tjerë si fondi për punën kërkimore për stafin pedagogjik të angazhuar në program. Ref: Shtojca 1, tabela nr 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Në evidencat e dorëzuara nga institucioni ka një evidencë nr. 49, për fillimin e procesit të auditimit të brendshëm. Në këtë evidencë përfshihet edhe një audit për zyrën e financës dhe shërbimeve administrative. Ref: Evidenca nr. 49 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm.pdf			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Programi i studimit nuk e ka mbyllur ende ciklin e plotë të studimit. Raportet financiare për vitet e kaluara, janë vetëm ato të përmendura më sipër (shiko kriteret 2 dhe 3, më sipër).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	Nga tabela e të ardhurave financiare të institucionit, vihet re një rënie e madhe në buxhet, nga zërat e buxhetit për Tarifat e shkollimit; Donacionet, Aktivitetet siguroese dhe Konsulencat, Shërbimet. Sipas tabelës përshkruese, shifrat e të ardhurave kanë lëvizur nga 108,568,660 për vitin 2018-2019 në 21,744,336, në vitin 2020-2021. Gjithsesi duhet përmendur që dokumentacioni nga institucioni, pra edhe tabela e shpenzimeve janë dorëzuar në muajin Dhjetor 2020, që është fillimi i këtij viti akademik, 2020-2021. <i>*Në këtë zë mungojnë donacionet apo konsulencat që po bëhen apo do të bëhen, gjatë kësaj kohe të vazhdimin të vitit akademik dhe ndërsa ky raport po shkruhet, të cilat institucioni mund t'i ketë pasuruar, por kanë ngelur pa u reflektuar në dosjen që është dorëzuar në fund të vitit të kaluar.</i> Ref: Shtojca 1, tabela nr 18 Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni zbaton politika për ciklin e plotë akademik për studentët, në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë (Nr. 80/2015). Institucioni ka hartuar politika të qarta për pranimin e studentëve, mënyrën e pranimit, vlerësimin, matjen e performancës dhe të tjera kritere që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve për programin, nga hyrja e studentëve në program deri në përfundimin e ciklit. Të gjitha këto specifika janë të përfshira në Rregulloren e Studimeve të cilën institucioni e ka paraqitur si evidencën nr. 4.</p> <p>Ref: Evidenca nr 4. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat e hartuara nga institucioni, për të gjithë ciklin e studimit, për të gjithë studentët, siç paraqiten në evidencën nr. 4, janë jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu institucioni ka në politika të përcaktuar edhe dy kategori si kategori të veçanta: studentët me aftësi ndryshe dhe studentët me aftësi të kufizuar.</p> <p>Ref: Evidenca nr 4. Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Institucioni ka të mirëpërcaktuara rregulloret dhe politikën në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve, përparimin e tyre vlerësimet dhe transferimet. Institucioni ka paraqitur si evidencë nr. 12, praktikën e ndjekur për përcaktimin e kriterëve për pranimin e studentëve të rinj. Sipas kësaj evidence Këshilli i Departamentit përcakton kritere të qarta për pranimin e studentëve të cilat më pas firmosen nga Shefi i departamentit, Rektori si dhe dërgohen pranë institucioneve përkatëse në Ministrinë e Arsimit. Të dhëna për këto kritere janë të pasqyruara edhe në faqen e ëbsite të institucionit për studentët apo kandidatët për studentë. Gjithsesi, për disa nga këto fusha p.sh. <i>transferimet</i>, materiali i gjendur në ëbsite është shumë i shkurtër dhe jo i elaboruar siç duhet.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 12 Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Institucioni harton dhe publikon kriteret për pranimin e studentëve të rinj, përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara dhe të përfshira edhe në Rregulloren e programit, të cilin institucioni e ka paraqitur si Evidencën nr.7, në dokumentacionin e vlerësimit të programit. Siç u përmend më sipër, këto kritere janë të përcaktuara sipas një praktike të shpjeguar në evidencën nr 12, që institucioni ka dorëzuar si pjesë të dokumentacionit për vlerësimin e këtij programi.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.pdf</p> <p>Ref: Evidencë nr. 12 Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve.pdf</p>

<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve janë të hartuara në bazë të legjislacionit përkatës dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Sipas evidencës së paraqitur nga departamenti, për pranimin e studentëve të rinj në këtë program ka dy kritere bazë: 1) mesatarja e shkollës së mesme dhe 2) intervistë nga komisioni i vlerësimit. Në këtë evidencë nuk ka kritere të veçanta për pranimin e studentëve të huaj. Nga intervistat e zhvilluara me stafin akademik dhe zyrat mbështetëse, u tha se në këtë program nuk ka studentë të huaj apo studentë që vijnë nga treva të tjera shqipfolëse, jashtë Shqipërisë.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 75 Praktika për miratimin e kuotave të pranimit.pdf</p>			
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni e bën informimin e publikut për ofertën për këtë program studimi nëpërmjet dy mënyrave: 1) publikimit të informacioneve në faqen e website të institucionit dhe 2) panairt rajonale që zhvillohen në fillim të çdo viti akademik. Këta të dhëna janë shorehur edhe në RVB të dorëzuar nga institucioni. Gjithsesi institucioni nuk ka paraqitur evidencë për pjesëmarrje në panairt rajonale, për promovimin e këtij programi studimi.</p> <p>Ref: Faqja online e institucionit www.Beder.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të informohen për sa i përket kriterëve për përparimin e tyre akademik nga njëri vit në tjetrin, si fillim në guidën e studentit. Ky udhëzues, në faqet 20-25 jep informacione për studentët për vlerësimet, provimet dhe kalimet nga njëri vit në tjetrin. Gjithashtu informacion për sa më sipër mund të merret edhe nga sekretaria mësimore.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 41 Guida e Studentit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Dy kanalet e komunikimit të përmendura më sipër: guida e studentit dhe Sekretaria mësimore, japin gjithashtu informacion edhe për sa i përket kriterëve dhe procedurave për njohjet e kualifikimeve të mëparshme. Gjithsesi, në Rregulloren e Studimeve për këtë program, në nenin 12, i titulluar Transferimet në Institucionet e Arsimit të Lartë, paragrafi shpjegues është shumë i përgjithshëm dhe ka nevojë për specifika të këtij institucioni në mënyrë që studentët, të kenë informacion më të detajuar.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 41 Guida e Studentit.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në çdo syllabus të lëndëve që studentët marrin gjatë semestrave të studimit në këtë program. Ndarja e komponentëve të vlerësimit është bërë konform rregullave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Sugjerohet që në disa nga këto lëndë (psh E folura në Publik), t'i jepet më shumë rëndësi</p>




	<p>vlerësimit të dijeve praktike të studentëve se sa atyre teorike. Lënda në fjalë p.sh., ka një provim final i cili vlerësohet me 60 pikë, ndërkohë që peshë më e madhe mund t'i ishin dhënë detyrave praktike të studentëve që lidhen me të folurën në publik.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 19 Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në guidën e studentit ka një seksion të veçantë që i kushtohet diplomimit (fq. 26). Në përgjithësi informacioni i dhënë është i vlefshëm dhe orientues për studentët. Do ishte me vlerë që në këtë seksion të përmendej edhe Këshilluesi akademik për diplomën, që institucioni e ofron nëpërmjet pedagogëve të cilët marrin përsipër supervizimin e temave të diplomës së studentëve. Gjithashtu një program më i specializuar i temave të cilat studentët kanë në dispozicion për t'i marrë ndërkohë që përgatiten për punimin e diplomës së tyre (ky të jetë i ndryshëm nga lënda Shkrim akademik apo Metodatat e Kërkimit Shkencor), do ishte i nevojshëm. Manuali që institucioni ka hartuar për përgatitjen e Temës së diplomës (evidence nr.87) edhe pse është një material i vlefshëm dhe i konsoliduar, është i shkruar në anglisht. Disa nga studentët mund të kenë vështirësi të kuptojnë këtë material.</p> <p>Ref: Evidencë nr. 41 Guida e Studentit.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 87 Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ndërmerr iniciativa të ndryshme për promovimin e ofertës së studimit, sipas informacioneve të ofruar në RVB. Përpos publikimit të informacioneve në faqen zyrtare, institucioni është edhe pjesë e organizimeve të ndryshme në nivel lokal, në formatin e panairove të studimit. Në faqen e institucionit, nuk ka pjesëmarrje në panairë të reflektuara për të promovuar këtë program studimi.</p> <p>Ref: Faqja online e institucionit www.Beder.edu.al</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka disa mënyra nëpërmjet të cilave sigurohet që studentët të marrin informacion të bollshëm përsa i përket, strukturës së studimeve, kohëzgjatjes dhe mënyrës së organizimit të programit. Një nga këto mënyra është edhe java e orientimit, e cila zhvillohet përpara fillimit të çdo viti akademik. Studentët që morën pjesë në intervistat me grupin e vlerësimit të jashtëm e konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në këtë javë orientimi. Informacioni për këtë javë është i përfshirë edhe në guidën e studentit.</p>

	<p>Përvec kësaj mënyrë institucioni sic është përcaktuar edhe në Rregulloren e studimeve, cakton edhe një këshilltar akademik i cili ndjek progresin e një grupi studentësh.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 41 Guida e studentit.pdf</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet mënyrave të përmendura më sipër vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacion të posaçëm për modulet, lëndët dhe veprimtaritë e ndryshme. Përveç guidës së studentit (e cila jep informacion pak më gjeneralist), studentët kanë mundësinë të aksesojnë info për çdo lëndë nëpërmjet sistemit BIS. Gjithashtu, java e orientimit i ndihmon studentët të marrin informacione të veçanta, për studimet e tyre.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 41 Guida e studentit.pdf</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për këtë qëllim institucioni ka ngritur zyrën e këshillimit të karrierës, me përfaqësuesin e të cilës, grupi i vlerësimit të jashtëm, pati edhe një takim. Kjo zyrë, është operacionale dhe ka si qëllim ofrimin e informacionit tek studentët përsa i përket mundësive të punësimit. Duke qenë se program i studimit që po vlerësohet është një program i nivelit bachelor, studentët e shohin këtë shërbim, si një mundësi për të marrë informacion në lidhje me intershipet e ndryshme. Sipas informacionit të oruar në RVB, evidencat prkatëse dhe bisedave me studentët, kjo është një pikë e fortë që institucioni u ofron atyre.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 46 Vendimi i keshillit te Departamentit per percaktimin e perfaqesuesi te karrieres.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 36 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë mundësi për të marrë informacion të përditësuar për proceset specifike të mësimin nëpërmjet mënyrave të cituara më sipër: ditëve të orientimit, prezantimit të lëndëve nga pedagogët në fillim të çdo viti akademik dhe sistemit BIS për informacione të tjera në lidhje me komponentët e vlerësimit, rezultatet etj.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 77 Programi i diteve te orientimit.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr.4 Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 41 Guida e studentit.pdf</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Institucioni ka një sistem të brendshëm të menaxhimit (BIS) i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët. Gjithashtu studentët kanë mundësi të kenë një adresë të personalizuar e-maili nëpërmjet të cilës shkëmbehet i gjithë informacioni mes tyre, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore. I gjithë ky system është lehtësisht i aksesueshëm edhe nga distanca, siç u vërtetua nga studentët në takimet që patëm më ta, për periudhën e komunikimit gjatë pandemisë, kur edhe studentët nuk ishin të pranishëm fizikisht në institucion.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 41 Guida e studentit.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V. 4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve															
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Nga informacionet e përfshira në RVB si dhe evidencat përkatëse të dërguara nga institucioni vihet re se institucioni ruan të dhëna të detajuara për çdo student dhe regjistrat përkatës. Një fakti i tillë u vërtetua edhe nga takimi me Sekretarinë Mësimore, ku u pa se si ruhen të dhënat e studentëve.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 28 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.pdf</p>															
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet zyrës së sekretarisë mësimore, harton raporte përsa i përket të dhënave statistikore për studentët. Gjithsesi në raportin e fundit vjetor të departamentit, seksioni për këtë program studimit, përfshinte vetëm mesataren e arritur nga studentët që studiojnë në këtë program. Raportet vjetore, duhet të përmbajnë edhe seksione më të detajuara për numrin e studentëve të këtij programi specifik, ndër vite, numrin e studentëve të tërhequr nga programi (nëse ka) etj.</p> <p>Ndërkohë një e dhënë e tillë është përfshirë si tabela nr.21, në shtojcën 1 të dërguar nga institucioni sëbashku me RVB.</p> <table border="1" data-bbox="683 990 1390 1182"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Regjistruar per here te pare</th> <th>C’regjistruar</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>20</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>19</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>16</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Ne total</td> <td>55</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ref: shtojcë 1 Tabela nr. 21 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve</p>	Viti akademik	Regjistruar per here te pare	C’regjistruar	2018-2019	20	-	2019-2020	19	-	2020-2021	16	-	Ne total	55	-
Viti akademik	Regjistruar per here te pare	C’regjistruar														
2018-2019	20	-														
2019-2020	19	-														
2020-2021	16	-														
Ne total	55	-														
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Zyra e sekretarisë mësimore të institucionit, përmban të dhënat për ecurinë e të gjithë studentëve në programin e studimit. Këto të dhëna ruhen në kopje fizike, në regjistër si dhe në sistemin BIS. Gjithashtu të dhënat janë të aksesueshme nga vetë studentët si dhe nga këshilltarët e tyre akademik.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 31 Listë e studentëve të tre viteve në program “Bachelor” në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.pdf</p>															
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>System i menaxhimit të brendshëm BIS, mundëson edhe nxjerrjen automatike të të dhënave statistikore, që lidhen me studentët dhe performancën e tyre. Sekretaria mësimore e institucionit, ka akses në këto të dhëna dhe siguron ruajtjen e tyre.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.pdf</p>															
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e</p>	<p>Siç u cek më sipër institucioni harton dhe paraqet të dhëna statistikore për cilësinë e studentëve të programit. Për këtë program specifik, mesatarja e viteve të studimit është e paraqitur në Raportin vjetor të Departamentit. Ndërkohë, zyra e Këshillimit të karrierës, bën një punë të mirë me orientimin e studentëve drejt tregut të punës, duke iu ofruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo intership-eve të ndryshme. Duke qenë se ky është fundi i ciklit të parë të studimeve për këtë program, nuk ka ende të dhëna për</p>															

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	shkallën e cilësisë së punësimit të këtyre studentëve të këtij programi specifik. Në takim më Zyrën e Këshillimit të Karrierës, grupit të ekspertëve u ofruan edhe të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve, të këtij departamenti. Ref: Evidenca nr. 74 Prezantimi i departamentit në analizën vjetore.pdf Ref: Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi organizimin akademik.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Nga informacione që institucioni ka përfshirë në RVB si dhe evidencat përkatëse, faktohet përfshirja e studentëve si dhe angazhimi i tyre në organe vendimmarrëse. Gjithashtu nga takimet në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm pati mundësinë për t'u takuar me disa përfaqësues të studentëve si dhe përfaqësues të organeve vendimmarrëse, në përbërje të të cilëve kishte dhe student (Dekani i Studentëve si dhe Njësia për sigurimin e Cilësisë). Këto dy organe dhe përfshirja e studentëve në to është në përputhje me ligjin e Arsimit të Lartë. Nga vizita dhe takimi me përfaqësues të organeve vendimmarrëse u vu re nevojitet një ndarje më e qartë e roleve të tyre. Më konkretisht, edhe Dekani i Studentëve edhe përfaqësuesi i zyrës së karrierës, përmendin të njëjtat aktivitete të organizuara për studentët. Ref: Evidenca nr. 39 Vendimi i senatit për përfshirjen e studentëve në këshillin e departamentit dhe në këshillat e fakulteteve.pdf Ref: Evidenca nr. 64 Zgjedhjet e Këshillit Studentor.pdf
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve të tyre apo lëndëve të ndryshme nëpërmjet plotësimit të anketave përkatëse të hartuara dhe ndara nga zyra për sigurimin e cilësisë. Gjithsesi, kjo përfshirje është më tepër në kuadër të plotësimit të anketave dhe nuk është e qartë nga raportimi i institucionit nëse studentët kanë një rol përtej plotësimit të anketave. Sipas intervistave të zhvilluara me përfaqësues të institucionit, roli i studentëve në dhënien e mendimit të tyre mbi mënyrën se si janë hartuar këto anketa, ndryshime të mundshme të përmbajtjes së tyre, është minimal. Garantimi i përfshirjes domethënëse të studentëve në procese vendimmarrëse të institucionit, mbi çështje që iu përkasin atyre drejtpërdrejtë, duhet të jetë më e qëllimshme. Ref: Evidenca nr. 17 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të	Ngarkesa akademike e studentëve të këtij profili është konform ligjeve të Arsimit të Lartë për numrin e krediteve që duhet të plotësojë një student për vitin akademik, e barazuar me 60 kredite. Ndërkohë edhe proceset e transferimit të studimeve janë të përcaktuara në rregulloren e programit të

studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	studimit. Departamenti sigurohet që ngarkesa akademike e studentëve të jetë kriter, kur bëhen rishikime të programeve të studimit, në mënyrë që barra të mos bjerë mbi studentët. Ref: Shtojca 1 Tabela 13 Ngarkesa totale e studentëve për secilin program Ref: Evidenca nr. 27 Rregullorja e transferimeve.pdf			
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Përfshirja e drejtpërdrejtë e studentëve në institucion bëhet nëpërmjet anketave që ata plotësojnë për lëndët dhe performancën e pedagogëve të tyre. Studentët e pyetur në takime, përmendin vetëm këto angazhime përsa i përket këtij indikator. Është e paqartë se si studentët apo kontributi i tyre në përmirësimin e procese të mësimdhënies, bëhet me baza të rregullta, përtej plotësimit të formave të anketimit. Ref: Evidenca nr. 24 Anketë vlerësimi e mendimit të studentëve ndaj institucionit.pdf			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Grupi i vlerësimit u njoh me një proces ankimimi note, (i cili i përkiste një programi tjetër) e paraqitur edhe si evidencë nr 59 në dosjen e dokumentave të institucionit. Edhe studentët gjatë takimeve përmendën mënyrat se si i adresonin pakënaqësitë e tyre në lidhje me ndershmërinë dhe barazinë e procesit të vlerësimit. Sipas studentëve ka lëndë që duhen përmirësuar, ka pedagogë që mund të përmirësojnë teknikat e tyre të mësimdhënies, por nuk është e qartë se si studentët i japin këto lloj komentesh edhe në departament dhe se sa këto mendime ndiqen më tej, nga institucioni. Ref: Evidenca nr. 59 Praktikë ankimim note.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka të gjitha njësitë e nevojshme për informimin e studentëve dhe për shërbimet që lidhen me mirinformimin e tyre mbi proceset e ndryshme të studimeve, në program. Më konkretisht Sekretaria Mësimore, Dekani i studentëve, Njësia e Sigurimit të Cilësisë, Këshilltari Akademik dhe zyra e planifikimit të karrierës, funksionet e të cilëve janë të përshkruara në RVB dhe janë dërguar evidencat përkatëse dhe me të cilët grupi i vlerësimit pati takime, në kuadër të këtij procesi vlerësimi, ishin të gjithë funksional dhe të angazhuar në punën me studentët. Ref: Evidenca nr. 28 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.pdf Ref: Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu.pdf Ref: Evidenca nr. 57 Rregullore mbi Organizimin Administrativ.pdf
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit	Në institucion një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe punës individuale me çdo student për përparimin e tyre. Kjo arrihet nëpërmjet Këshilltarit akademik, i cili ka si detyrë mentorimin (akademik së pari por edhe profesional) të një grupi studentësh për të cilët është përgjegjës. Të gjithë

të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	studentët kanë mundësi të kenë një këshilltar akademik, i caktuar nga departamenti. Ref: Evidenca nr. 45 Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademikë.pdf			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Studentët në këtë program kanë mundësinë të marrin shërbime nga zyra e këshillimit të karrierës. Kjo zyrë në vitet e fundit kishte organizuar disa aktivitete për përfitimin e studenteve si: praktika profesionale me kompani të njohura në vend, trajnime të paguara, etj. Zyra ishte në kontakt me studentët nëpërmjet e-maileve që dërgonte më informacione por edhe takime. Duke qenë se ky program që po vlerësohet nuk e ka mbyllur ende ciklin e plotë, puna për orientimin e studentëve në tregun e punës, mbetet për t'u bërë në muajt në vazhdim. Gjithsesi, përfaqësuesi i zyrës na njohu me statistika që institucioni kishte në dispozicion për punësimin e ish-studentëve. Dukej që shumica e studenteve të nivelit Bachelor, zgjidhnin edhe të vazhdonin studimet Master në të njëjtin institucion. Ref: Evidenca nr. 94 Lista e praktikave profesionale të studentëve.pdf Ref: Evidenca nr. 45 Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademikë.pdf Ref: Evidenca nr. 36 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas të dhënave të ofruara nga zyra e planifikimit të karrierës në institucion, niveli i punësimit të studentëve në Master ishte 95%, ndërkohë që për studentët e nivelit Bachelor, kjo shifër ishte 80%. Sipas përfaqësuesit të kësaj zyre, në nivelin e punësimit të studentëve të ciklit Bachelor, punësim quhet edhe puna me kohë të pjesshme, duke qenë se shumica e këtyre studentëve vazhdojnë studimet në nivelin Master. Një aktivitet për t'u përmendur është edhe Bedër Alumni Aëards, që institucioni organizon mes brezave të të diplomuarëve në këtë departament edhe si një mënyrë për shkëmbim përvojë dhe mirenjohje ndaj studentëve. Evidenca nr. 51 Gjurmimi i të Diplomuarve.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ka ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë së brendshme e cila është funksionale dhe ka në përbërje të saj katër anëtarë, dhe një student. Kjo njësi operon në përputhje me parashikimet ligjore të Arsimit të Lartë dhe atyre të vetë institucionit.</p> <p>Detyra kryesore e njësisë është hartimi, zhvillimi dhe nxjerrja e gjetjeve për cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet anketave të zhvilluara. Në institucion zhvillohen në mënyrë periodike 5 anketa: anketa e stafit administrative për vlerësimin e institucionit; anketa e pedagogëve për vlerësimin e institucionit; anketa e studentëve për vlerësimin e lëndëve; anketa e studentëve për vlerësimin e institucionit si dhe këtë vit ishte shtuar edhe anketa e studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimin të zhvilluar online.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf Ref: Evidenca nr. 40 Vendim i senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në Kolegjin Universitar Bedër, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2014. Që nga ajo kohë, IAL ka institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) [Evidencë nr 30], si dhe në përputhje me ligjin 80/15 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional [Evidencë nr.21]. Në NJSBC, bën pjesë edhe një përfaqësues nga Këshilli studentor. Studentët, gjithashtu, janë të përfshirë si pjesë e grupit të punës në çdo rast kur institucioni realizon akreditimin institucional apo akreditimin e programeve të studimit, si dhe gjatë realizimit të pyetësorëve.</p> <p>Njësia e sistemit të brendshëm të cilësisë bën edhe rishikimin e anketave të hartuara. Na u komunikua se këtë vit, përmbajtja e anketave u rishikua dhe u përditësua.</p> <p>Ndërkohë për masat e marra nga gjetjet e anketave, përgjegjësia i kalon organizmave të departamentit, Rektorit dhe më pas Dekanit. Ndërkohë rezultatet e anketave me studentët, përfaqësuesja e njësisë i komunikon në faqen e web. Nga një shikim i kësaj faqeje del se rezultatet e anketave të publikuara aty, kanë nevojë të përditësohen pasi i përkasin viteve të mëparshme, të hershme.</p> <p>Gjithashtu, për stafin akademik që janë pjesë e kësaj njësie, duhet të sigurohet që përfshirja e tyre në këto procese të jetë domethënëse dhe të balancohet me detyrat e tjera që kanë në departament të lidhura më ngarkesën mësimore dhe atë kërkimore.</p> <p>IAL, ka një plan strategjik për periudhën 2018-2023 [Evidenca nr. 8], në të cilin janë parashtruar edhe masa dhe plane për rritjen e cilësisë së arsimit.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf Ref: Evidenca nr. 21 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë.pdf Ref: Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Beder 2018-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e</p>	<p>Institucioni ka instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë në program dhe i përdor ato në baza të rregullta. Gjithashtu institucioni ka qenë subjekt edhe i vlerësimeve institucionale të jashtme, në vitet e mëparshme. Në vlerësimin periodik institucional [Nr. 101 dt. 10.11.2017] IAL është vlerësuar</p>

<p>lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>pozitivisht, me njëvlerësim të përgjithshëm si ‘përmbushen kryesisht’ për kriteret dhe me një akreditim insituacional me kohëzgjatje prej 4 vitesh.</p> <p>Proceset e vlerësimit të cilësisë, përfshijnë më së shumti kryerjen e anketave sistematike. Mungojnë mënyrat alternative të matjes së cilësisë, si për shembull organizimi i fokus grupeve me grupe të caktuara studentësh për çështje të caktuara.</p> <p>Për programin që po vlerësohet, zyra nuk raporton asnjë proces ankimimi, ose rishikimi të vlerësimeve të studentëve për pedagogët, sepse nuk ka pasur.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 78 Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar “Bedër”.pdf</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang insituacional, të njëjive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka të hartuar procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve që ofron. Gjithsesi, të pyetur për ndjekjen e gjetjeve nga anketat, për shembull, çfarë ndodh nëse një pedagog del shumë keq në vlerësim apo shumë mirë, përfaqësuesja e zyrës sqaron se këto janë kompetenca të organizmave më të larta në departament. Ndërkohë institucioni e ka të vështirë për të ofruar një sistem anti-plagjiaturë për studentët, apo edhe stafin pedagogjik, pasi shumica e studimeve janë në shqip dhe një platformë e tillë nuk ekziston.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni ka të ngritura dy njësi me qëllim sigurimin e cilësisë në programet e studimit. Këto njësi janë Njësia për sigurimin e cilësisë dhe komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve për sigurimin e cilësisë. Rolet dhe përgjegjësitë e NJSBC është i mirëpërcaktuar në rregulloren përkatëse e paraqitur si evidencë nr. 30. Në këtë dokument, roli i komisionit të përhershëm të garantimit të cilësisë është lënë vetëm si përcaktim i ‘një organi kolegjal i cili kryen funksione që lidhen kryesisht me garantimin e cilësisë ...’.</p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm pyeti se si ndahen këto role, midis dy organizmave. Komisioni i Përhershëm për Ggarantimin e Standardeve dhe Cilësisë Institucionale, si organ kolegjal koordinon procesin dhe nxjerr urdhëra dhe dekrete të cilat duhet të zbatohen më pas nga NJSBC.</p> <p>NJSBC është organi i cili është përgjegjës për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore,</p>

	monimotimin e veprimtarive në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ dhe kontrollin periodik të cilësisë në institucion. Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.pdf			
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni ka një sistem hierarkik institucional për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit. Institucioni ka një zyrë përkatëse, zyra e Zhvillimit të Kurikulave e cila ka si funksion monitorimin e këtij procesi ndryshimi i cili nis në departament dhe kalon në mënyrë vertikale në gjithë organizmat brenda institucionit për vendimmarrje si Departament-Fakultet-Rektorat dhe në fund në Senat. Ref: Evidenca nr. 73 Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulës.pdf			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Institucioni ka të zhvilluara një sërë formash anketimi të cilat e masin cilësinë e programeve nëpërmjet disa pikëpamjeve: atë të studentëve, stafit pedagogjik dhe stafit administrative. Këto instrumente janë të hartuara dhe miratuara, ndërkohe që përmbajtja e tyre rishikohet, herë pas here. Ref: Evidenca nr. 34 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve.pdf			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e anketimeve, pasi zhvillohen dhe dokumentohen i kalohen instancave më të larta në institucion, departamentit dhe rektoratit, të cilat janë përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Ref: Evidenca nr. 34 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve.pdf			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Institucioni publikon gjetjet e proceseve të vlerësimit në faqen e tij të ëeb. Gjithsesi informacioni I gjendur në këtë faqe ka nevojë për përditësim pasi nuk përfshin vitet e fundit. Ndërkohë, institucioni ka ofruar si evidence edhe një vlerësim të bërë së fundmi mbi kërkimin shkencor. Ky dokument përfshin gjetjet nga procesi I vlerësimit si dhe vendos afate kohore për realizimin e tyre. Është e nevojshme të paraqiten edhe raporte vlerësimi që përmbajnë informacion mbi si janë adresuar mangësitë e gjetura në proceset e vlerësimit për përmirësimin e cilësisë. Ref: faqja online e IAL www.bedër.edu.al			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të	Institucioni ka njësinë për sigurimin e cilësisë e cila është e angazhuar për vlerësimin e dy komponentëve të programit në mënyrë periodike: cilësinë e stafit akademik dhe të lëndëve. Këto dy vlerësime bëhen në fund të semestrit, pasi lënda është ofruar për studentët. Gjetjet që dalin nga këto procese anketimi, raportohen tek zyra e Zhvillimit të kurikulës, për përshtatje të elementeve që kanë të bëjnë me kurikulës. Ndërkohë çështjet që lidhen me stafin akademik, adresohen në departament.

<p>vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Ref: Evidencë shtesë nr.8: Praktika e hartimit të project buxhetit nga departamenti Ref: Evidencë shtesë nr. 9: Marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale Ref: Evidencë shtesë nr. 10: Marrëveshje bashkëpunimi për kërkimin shkencor, shkëmbimin e stafit dhe studentëve, etj. Ref: Evidenca nr. 17 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf Ref: Evidenca nr. 71 Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit.pdf Ref: Evidenca nr. 34 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve.pdf Ref: Evidenca nr. 70 Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit të përdorura për matjen e cilësisë në këtë program janë një numër i konsiderueshëm anketash të cilat e matin performancën e programit nga disa pikëpamje: ajo e studentëve, stafit pedagogjik, stafit administrative.</p> <p>Përveç këtyre teknikave formale të matjes, studentët mund edhe të komunikojnë dhe shprehin shqetësimet e tyre pranë zyrave që janë në shërbim të tyre si p.sh. ajo e sekretarisë mësimore, këshillimit të karrierës, dekani i studentëve etj.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 28 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.pdf Ref: Evidenca nr. 101 Raport i Zyrës së planifikimit të karrierës.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor një anketë vlerësimi nga studentët me në fokus cilësinë e mësimdhënies si dhe një anketë vetëvlerësimi të pedagogut [Evidencat 17 dhe 85].</p> <p>KU BEdër përdor edhe metoda të tjera për vlerësimin e cilësisë së stafit, disa prej tyre të përfshira edhe në pyetësorët e organizuar me studentët.</p> <p>KU BEDER ka edhe një formular për vlerësimin e performacës së stafit.</p> <p>Ref: Evidencë shtesë nr.11 Formulari i vlerësimit të performancës së stafit Ref: Evidenca nr. 17 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf Ref: Evidenca nr. 85 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për</p>	<p>Institucioni nuk raporton për përdorimin e teknikave të tërthorta të matjes së realizimit të programit, siç mund të jenë fokus grupet me studentë të ndryshëm mbi çështje të veçanta, pyetësorë të paplanifikuar me studentët apo stafin akademik.</p> <p>Institucioni ka kryer pyetësorë për çështje të cilat kanë qenë urgjente dhe të paplanifikuara, si p.sh. mësimi online për shkak të Covid-19 [Evidencë nr. 42] , pyetësor i kryer me studentët për të mësuar më mirë mbi gjendjen e tyre dhe përvojën me mësimin online.</p> <p>Vihet re një fokus i madh tek studentë si target grup për pyetësorët në lidhje me performancën e programit. Për stafin pedagogjik, përveç pyetësorit të plotësuar nga studentët, nuk raportohet për instrumente të</p>

vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	tjerë të matjes së cilësisë, si mund të jenë p.sh: vlerësimi nga një koleg që asiston një orë mësimi-sidomos për pedagogët e rinj; vlerësim nga shefi i departamentit që asiston një orë leksioni, etj. (shiko kriterin më sipër) Ref: Evidenca nr. 42 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Institucioni ka të përfshirë si anëtarë në njësinë e Sigurimit të Cilësisë, një student dhe një ekspert të jashtëm. Të dy anëtarët që përfaqësojnë këto grupe, i janë shtuar kësaj njësie, në fund të vitit të kaluar (Dhjetor 2020). Ndërkohë që anëtarët e brendshëm të stafit, I janë shtuar njësisë, në janar të vitit 2020.</p> <p>Ndërkohë, njësia e Sigurimit të Cilësisë, është operationale dhe zhvillon rregullisht procese të matjes së cilësisë në institucion duke përfshirë të gjitha grupet e interesit, si: studentë, stafin pedagogjik, stafin administrative.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në institucion përta i përket sigurimit të cilësisë luan edhe Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë i cili harton politikat dhe monitoron zbatimin e tyre.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Institucioni i ka të mirëhartuara përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë instancat e përfshira në sigurinë e cilësisë. Ky informacion është i përfshirë dhe artikuluar në Rregulloren e funksionimit të NJBVC, e cila është hartuar në vitin 2014 dhe në dokument thuhet se është përditësuar një herë, por nuk jepet datë për përditësimin e saj.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf</p> <p>Ref: Evidencë shtesë nr.12: Aneks kontrate e Ekspertit të Jashtëm për NJSBC</p>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	<p>Në proceset e vlerësimit të cilësisë në institucion ka një gjithë përfshirje të aktorëve të institucionit që përfshijnë: studentët, stafin akademik dhe stafin administrative. Njësia bën një koordinim të mirë të punës për mbledhjen dhe shpërndarjen e gjetjeve të proceseve të vlerësimit me njësinë baze dhe atë kryesore për këtë program studimi.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf</p>

<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Njësia e sigurimit të cilësisë, nëpërmjet hartimit të pyetësorëve dhe plotësimit të tyre në mënyrë anonime dhe ciklike, respekton integritetin akademik dhe shmang procese diskriminuese apo pabarazie mes stafit apo studentëve.</p> <p>Pyetësorët, janë të hartuar në atë mënyrë që masin jo vetëm cilësinë e stafit pedagogjik por edhe performancën e lëndës. Gjithashtu, pyetësorët përmbajnë edhe indikatorë sasior dhe cilësor, për ta bërë më të plotë matjen.</p> <p>Ref: Evidence nr. 34 Rregullorja e anketave dhe vleresimeve</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Siç u përmend më sipër, në Rregulloren e Njesisë për Sigurimin e Cilësisë në institucion, është përcaktuar që një prej anëtarëve të kësaj njësie, të jetë një ekspert i jashtëm dhe anëtari tjetër të jetë një student. Të dy këta anëtarë, i janë shtuar njësisë në fund të vitit 2020 (23.12.2020)</p> <p>Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Studentët njihen me procedurat e matjes së cilësisë në institucion, pasi bëhen subjekte për plotësimin e pyetësorëve të hartuar nga njësia. Nuk raportohet për kontribut të drejtpërdrejtë të studentëve në hartimin, rishikimin e formave të përdorura nga kjo njësi apo edhe pjesëmarrjen e tyre në veprimtari të kësaj njësie (që nuk lidhen vetëm me plotësimin e pyetësorëve).</p> <p>Gjithsesi në planin e fundit strategjik të institucionit [Evidenca nr. 8], parashikohet një fokus i shtuar tek përfshirja e studentëve në rritjen e cilësisë së IAL.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 8 Plani Strategjik Institucional i KU Beder 2018-2023.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e programit të studimit, publikohen në faqen e web të departamentit. Nga aty të gjithë të interesuarit njihen me këto rezultate. Ndërkohë nga një kontroll i thjeshtë në faqen e eeb del se rezultatet e fundit të publikuara, janë nga disa vite më herët.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 78 Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar “Bedër”.pdf</p> <p>Ref: Evidenca nr. 79 Urdhër nr.28 dhe 29, datë 12.04.2019 “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Komunikimi”.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan</p>	<p>Siç është përmendur edhe më lart (shiko Standardin VI.2 - kriteri 5) institucioni ka ofruar si evidence [nr.92] edhe një vlerësim të bërë së fundmi</p>

<p>masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>mbi kërkimin shkencor. Ky dokument përfshin gjetjet nga procesi i vlerësimit si dhe vendos afate kohore për realizimin e tyre. Është e nevojshme të paraqiten edhe raporte vlerësimi që përmbajnë informacion mbi si janë adresuar mangësitë e gjetura në proceset e vlerësimit për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 92 Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor.pdf; Ref: faqja online e IAL www.bedër.edu.al</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB dhe evidencave të paraqitura në dokumentacion [nr.49] institucioni e konsideron këtë njësi të rëndësishme dhe bën përpjekje që njësia të marrë vëmendjen e duhur në instancat e tjera brenda institucionit, si dhe proceset të kryhen sikundër janë parashikuar në rregulloet përkatëse [Evidencë nr.30].</p> <p>Gjithashtu edhe puna koordinuese e bërë nga njësia me njësinë kryesore dhe atë bazë për programin, është e mirë dhe kjo u reflektua edhe në mënyrën e organizmit të proceseve për këtë vlerësim të jashtëm.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 49 Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm.pdf Ref: Evidenca nr. 30 Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC.pdf</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni sigurohet që studentët dhe stafi akademik të marrin një informacion bazë për sa I përket sigurimit të cilësisë në institucion në takimet e orientimit që zhvillohen me studentët dhe stafin akademik të programit [Evidencat 77,41 dhe 53]. Materialet informuese si Guida e Studentit dhe ajo e Personelit, kanë informacion të përgjithshëm mbi proceset vlerësuese në institucion, edhe pse nuk është specifik për proceset dhe politikat që ndërmerr institucioni për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Ref: Evidenca nr. 41 Guida e studentit.pdf Ref: Evidenca nr. 53 Guida e Personelit.pdf Ref: Evidenca nr. 77 Programi i diteve të orientimit.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu” të “Kolegjit Universitar “BEDER”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Personeli përgjegjës akademik për zbatimin e programit, sidomos stafi me kohë të pjeshme, vjen nga përvoja punësimi në sektorët e aplikueshëm të marrëdhënieve me publikun dhe marketingu;
2. Qëndrueshmëria e stafit akademik të brendshëm;
3. Institucioni ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me aktorë të jashtëm në mbështetje të përfitimit të studentëve për praktika pune;
4. Angazhimi i studentëve në praktika formuese, në biznese dhe kompani të njohura në tregun shqiptar;
5. Informimi i studentëve mbi proceset e të mësuarit dhe aktivitetet e organizuara nga institucioni dhe mundësitë për pjesëmarrje në aktivitete formuese të natyrës akademike;
6. Media online www.objektiv.al një mundësi më shumë për të bërë praktikë dhe për studentët për të patur njohuri nga tregu mediatik.
7. Mbështetja e studentëve për planifikimin e karrierës;
8. Pjesëmarrje aktive e drejtuesve të programit në media sipas fushave respektive ndihmon në PR për programin dhe shembull konkret për lëndë të veçanta për studentët;
9. Grupe të vogla studentësh, (jo masive) krijon mundësinë për punë më specifike dhe të detajuar me studentët, e shprehur më shumë në lëndët praktike;
10. Sistemi i brendshëm i komunikimit BIS që lehtëson procesin e mësimdhënies dhe krijon interaktivitet midis studentëve dhe stafit.
11. Ndërthurja dhe bashkëpunimi me departamentet e tjera të KU BEDER për të pasqyruar mediatikisht aktivitetet që zhvillohen në institucion.

Pika të dobta:

1. Burimet njerëzore administrative, mbështetëse për programin janë me kapacitet të kufizuar;
2. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, e shprehur më shumë në lëndët teknike të profesionit. Nevoja për plotësimin e saj/përkthimin gradual, në funksion të proceseve të të mësuarit për studentët e programit;
3. Një skemë jo e qartë financimi për kërkimin shkencor në lidhje me programin, ku të përfshihen edhe studentët;
4. Nevoja për forcimin e komponentit të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare universitare dhe futja në network universitare, duke respektuar statusin e Kolegjit Universitar (që është i ndryshëm nga ai si Universitet);

Rekomandime:

1. Institucioni duhet të marrë masa për shtim në personel veçanërisht për zyrën e burimeve njerëzore, për një mbështetje më të madhe për stafin pedagogjik;

2. Institucioni duhet të bëj përpjekje më të mëdha për përkthime të literaturës së huaj për programin, në gjuhën shqipe dhe vënien e tyre në dispozicion të studentëve (Pavarësisht se ka një literaturë të gjerë në gjuhën angleze). Plotësimi me literaturë shqipe është një proces i vazhdueshëm dhe i tillë për të gjitha institucionet e arsimit të lartë.
3. Institucioni duhet të synojë për shtim të burimeve financiare dhe njerëzore në funksion të pasurimit të kërkimit shkencor për stafin e programit;
4. Institucioni duhet të synojë studentë shqipfolës nga treva jashtë Shqipërisë, për t'u bërë pjesë e programit;
5. Institucioni duhet të synojë përfshirje më të qëllimshme të studentëve në hartimin e politikave, formateve të anketimit për matjen e cilësisë së programit;
6. Institucioni duhet të bëj përpjekje më të mëdha për diversifikimin e instrumenteve për matjen e cilësisë së programit që të përfshijë edhe metoda të përziera për matjen (si fokus grupet);
7. Institucioni duhet të marrë masa për informimin më të mirë të studentëve mbi gjetjet e proceseve të rregullta të vlerësimit të cilësisë dhe hapat e ndërmarra nga institucioni për këtë qëllim;
8. Institucioni duhet të forcojë më tej mobilitetet e studentëve me universitetet jashtë vendit, në kuadër të projekteve, për të kapërcyer edhe ndikimin nga pandemia COVID-19 e këtyre dy viteve. Departamenti dhe KUB në tërësi duhet të forcojë komponenten e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, për kërkimin shkencor si edhe projektet e BE. Kjo është sidomos e nevojshme në ato të projekteve universitare dhe shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle, Bachelor in "Public Relations and Marketing Communication" of the University College "BEDER"

Strengths and affirmations:

1. Faculty staff responsible for program delivery, especially part-time faculty staff, comes from practical working experiences in applied fields of Public Relations and Marketing;
2. Sustainability of full –time faculty staff;
3. Establishing of fruitful and sustainable relations with other actors for the benefit of students internships;
4. Engagement of students in formation activities with businesses and other renowned companies in Albania;
5. Informing students on learning processes and activities organized by the Higher Education Institution and opportunities for participation in academic related activities;
6. Online media Media www.objektiv.al an added opportunity for students to practice and get informed on how the Albanian media market, operates;
7. Supporting students on career plans;
8. Active participation of departament leader(s) in media, based on their respective fields of expertise, supports the PR for the program and provides a concrete example on doing PR for specific courses for students;
9. Small groups of students (not massive) creates an opportunity for a more focused and detailed work with them, mostly for practical courses;

10. Internal communication system BIS, facilitates the teaching process and creates opportunities for interactive communication between students and faculty staff;
11. Integration and collaboration with other departments at KU BEDER to showcase in media, activities that the institution organises.

Weaknesses

1. Administrative human resources, supporting the program are limited;
2. Lack of literature in Albanian language, especially dedicated to technical courses for the program. There is a need for fulfillment/translation of textbooks, for the benefit of students learning processes, in the program;
3. An unclear financial supporting scheme for academic research for the program, which encourages students participation;
4. There is a need to strengthen participation in international research projects and affiliation in academic networks, in respect to the Status of Beder University College.

Recommendation

1. The Institution should take measures for added personnel, especially for the Human Resources department, to be able to provide a bigger support for academic staff;
2. The Institution should increase efforts for translating foreign language literature to Albanian, and make them accessible for students (despite the fact that the institution does have a wide range of literature in English, available). Such process is a continuous need for all higher education institutions, in Albania;
3. The Institution should aim for enriching its financial and human resources dedicated to the progress of academic research for faculty staff;
4. The Institution should target albanian speaking students who live in regions outside Albania, as potential students to become part of the program;
5. The Institution should aim for a more intentional participation of students in drafting of policies, and survey templates for quality assurance, in the program;
6. The Institution should make more progress in diversifying its instruments for quality assurance, by also including alternative methods (such as focus groups);
7. The Institution should take measures for a better sharing of information with students on findings from the regular processes of quality assurance and steps taken towards addressing of findings and recommendations;
8. The Institution should further strengthen students mobilities with foreign universities, in the framework of joint programs, as a way to (also) reduce impact created by the Covid-19 pandemic. The Department and KUB as a whole, should strengthen further participation in international projects on academic research and EU- related projects. This is highly recommended especially for projects which aim at students and staff mobilities.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X